



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.8

2005

21 shkurt

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4479 datë 14.2.2005	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	335
Vendim i KM nr.38, datë 13.1.2005	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Shijakut të mjediseve dhe të truallit funksional të pronës “ish-brigadë këmbësorie” në Shijak, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	336
Vendim i KM nr.80, datë 28.1.2005	Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore.....	336
Vendim i KM nr.81, datë 4.2.2005	Për miratimin e protokollit të bisedimeve për bashkëpunimin, financiar dhe teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për vitin 2004, dhe të amendamenteve të tij.....	342
Vendim i KM nr.84, datë 11.2.2005	Për krijimin e Entit të Turizmit.....	351

Vendim i KM nr.85, datë 11.2.2005	Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion, të formës “BOO”, të një sipërfaqeje përreth fabrikës së çimentos, Fushë-Krujë.....	353
Vendim i KM nr.86, datë 11.2.2005	Krijimin e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura.....	355
Vendim i KM nr.87, datë 11.2.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	357
Vendim i KM nr.93, datë 11.2.2005	Për një shtesë në vendimin nr.310, datë 14.5.2004 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e personaliteteve të larta shtetërore, të cilët do të ruhen nga Garda e Republikës së Shqipërisë pas lirimit nga funksioni, dhe për një ndryshim në vendimin nr.422, datë 12.9.2002 të Këshillit të Ministrave “Për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore””.....	359
Urdhër i MF nr.9685,datë 23.12.2004	Për disa ndryshime në urdhrin nr.2152, datë 2.4.2002 “Për përcaktimin e fondit të ngurtësimit për garancinë e fituesit për lojërat e fatit, kërkesa për drejtuesit dhe personelin kryesor të shoqërisë”.....	359
Vendim i GJK nr.4, datë 10.2.2005	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.368, datë 5.3.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	360
Vendim i BSH nr.3, datë 26.1.2005	Për një ndryshim në rregulloren “Për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”.....	362
Vendim i ERE nr.4, datë 1.2. 2005	Për mospërcaktimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike shoqërisë Korsel sh.p.k.....	363
Vendim i ERE nr.5, datë 1.2.2005	Për përcaktimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike shoqërisë Marjakaj sh.p.k.....	363
Vendim i AMS nr.12, datë 28.1.2005	Për miratimin e rregullores “Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit”.....	364
Rregullore e AMS nr.5, datë 28.1.2005	“Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit”.....	364
Udhëzim i KQZ nr.1, datë 10.2.2005	Për organizimin dhe funksionimin e Zyrave Rajonale Zgjedhore...	368
Vendim i KKRT nr.305, datë 28.1.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Bajram Curri”.....	371
Vendim i KKRT nr.306, datë 28.1.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Radio 7”.....	372
Vendim i KKRT nr.307, datë 28.1.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Emanuel”.....	372

Vendim i KKRT nr.308, datë 28.1.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit radifonik “Radio e parë”.....	373
Vendim i KKRT nr.309, datë 28.1.2005	Për dhënie licence televizionit kabllor privat “Kruja”.....	373
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Festim Bezat Beqiri.....	374
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Rexhep Ypi.....	374

DEKRET
Nr. 4479, datë 14.2.2005

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-----------------------------------------|------------------------------------|
| 1. Kolë Gjokë Gjoka | 24. Flamur Fatmir Rira |
| 2. Adriano Smajl Mehja | 25. Zamir Shyqyri Elezi |
| 3. Altin Nikolla Simaku | 26. Albert Riza Shkurtaj |
| 4. Eli Sami Klos (Alliu) | 27. Sara Albert Shkurtaj |
| 5. Adnan Sami Qyqja | 28. Merial Albert Shkurtaj |
| 6. Fjoralba Fatmir Qyqja (Pasholli) | 29. Anila Ymer Shkurtaj (Beqiri) |
| 7. Irma Ndue Dockhorn (Gega) | 30. Alberto Fatmir Merkaj |
| 8. Ilir Jusuf Vezi | 31. Ermira Gjolek Çapaj (Rakipaj) |
| 9. Dashamir Gani Disha | 32. Adrian Ibrahim Shehu |
| 10. Ingrid Fisnik Mlera (Preza) | 33. Fatmira Sami Nano |
| 11. Steven Paulin Mlera | 34. Amarildo Edmond Pobrat |
| 12. Vjollca Islam Göbel (Gordani) | 35. Gabriela Edmond Nano |
| 13. Lulash Gjok Lumaj | 36. Shpëtim Edmond Nano |
| 14. Frida Myrteza Tetzl (Bimi) | 37. Ferdinand Thoma Mita |
| 15. Astrit Shasho Shukullari | 38. Natalia Ferdinand Mita |
| 16. Kristina Pavli Shukullari (Mirashi) | 39. Felix Ferdinand Mita |
| 17. Agron Astrit Shukullari | 40. Diana Sejamit Mita (Mehmetaj) |
| 18. Elton Astrit Shukullari | 41. Genci Besim Gozhdari |
| 19. Natasha Demir Lenz (Beshiraj) | 42. Pëllumbeshë Urim Hoxhaj (Azis) |
| 20. Rexhep Ismail Halili | 43. Vilson Kamber Kamberi |
| 21. Manjola Bashkim Ferati (Tota) | 44. Ilir Dikë Doçi |
| 22. Bashkim Mustafa Berisha | 45. Adem Lulash Isaak (Krasniqi) |
| 23. Blerta Bashkim Berisha | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 38, datë 13.1.2005

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË SHIJAKUT TË MJEDISEVE DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË PRONËS “ISH-BRIGADË KËMBËSORIE” NË SHIJAK, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-brigadës së këmbëorisë në Shijak (pesë objektet dhe trualli i tyre funksional) me sipërfaqe të përgjithshme 2361 m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Shijakut, për sistemimin me zyra të kësaj bashkie.

2. Prona me numër rendor 211, “Ish-brigadë këmbësorie, Shijak”, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Shijakut i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e kësaj prone, të përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Shijakut të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 80, datë 28.1.2005

PËR PËRBËRJEN, MËNYRAT E FUNKSIONIMIT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHTETËRORE TË MBROJTJES SË TOKËS BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
KOMITETI SHTETËROR I MBROJTJES SË TOKËS (KSHMT)

A.1. Komiteti Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës, si organ ndërministror, ka këtë përbërje:

- Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit
- Zëvendësministri i Mjedisit
- Një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë

kryetar;
zëvendëskryetar;
anëtar;

- Një përfaqësues nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit	anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Financave	anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit	anëtar;
- Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë	anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit	anëtar;
- Drejtori i Menaxhimit të Tokave, në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit	anëtar;
- Drejtori i Mbrojtjes së Natyrës, në Ministrinë e Mjedisit	anëtar;
- Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit	anëtar.

2. Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit të jenë në nivel drejtor drejtorie, veprimtaria funksionale e të cilëve lidhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, me detyrimet, që rrjedhin nga dispozitat e ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 “ Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

3. Titullarët e institucioneve përkatëse, brenda muajit janar të çdo viti, të njoftojnë me shkrim Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, me cilësinë e kryetarit të KSHMT-së, për personin e caktuar si përfaqësues të tyre në përbërje të këtij komiteti.

B. Mënyra e funksionimit

1. KSHMT-ja thirret në mbledhje me njoftim të kryetarit, jo më pak se një herë në 6 muaj, por në raste të veçanta, që vlerësohen nga kryetari, mund të mbledhet në çdo kohë.

Në mbledhje të KSHMT-së ftohen të marrin pjesë edhe specialistë të fushës dhe drejtues të organeve të qeverisjes vendore, sipas çështjeve konkrete që trajtohen.

2. Vendimet në KSHMT merren kur janë të pranishëm më shumë se 50 për qind e anëtarëve dhe janë të vlefshme kur për to votojnë më shumë se 50 për qind e anëtarëve të pranishëm.

Kur nga votimi rezultojnë vota të barabarta në numër, vota e kryetarit është përcaktuese në marrjen e vendimit.

Ndërmjet dy mbledhjeve të KSHMT-së mund të merren vendime të përkohshme nga kryetari, zëvendëskryetari dhe drejtori i menaxhimit të tokave. Këto vendime paraqiten për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e radhës së KSHMT-së. Kur vendimet e përkohshme nuk miratohen nga KSHMT-ja, ato shfuqizohen me efekte prapavepruese.

3. Roli i sekretariatit të KSHMT-së kryhet nga Drejtoria e Menaxhimit të Tokave në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, e cila ka për detyrë përgatitjen e dokumenteve dhe të materialeve të mbledhjeve të KSHMT-së dhe administrimin e akteve, që miratohen nga KSHMT-ja.

C. Detyrat dhe përgjegjësitë

1. KSHMT-ja ka për detyrë bashkërendimin e punëve ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Ministrisë së Mjedisit, institucioneve të tjera dhe organeve të qeverisjes vendore, për të gjitha veprimtaritë, që kryhen mbi tokën bujqësore, lidhen me të dhe ndikojnë në mbrojtjen e saj.

2. Veprimtaritë që shqyrtohen dhe bashkërendohen nga KSHMT-ja janë programet dhe projektet afatgjata, afatmesme dhe vjetore, të cilat paraqiten në muajin gusht të çdo viti dhe kanë si objekt:

a) përmirësimin e sistemit të kullimit dhe të ujitjes në hapësirën e tokës bujqësore dhe që përfshihen në territorin e dy ose më shumë qarqeve;

b) përmirësimin e masave antierozive, nëpërmjet ndërtimit ose ngritjes së disa veprave të veçanta antierozive, brenda një territori të caktuar, si pyllëzime, kanale të ujërave të larta, prita malore etj.;

c) përmirësimin e masave mbrojtëse të brigjeve të lumenjve, rrjedha e të cilave përshkon territoret e dy ose më shumë qarqeve;

ç) programet dhe projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit ose donatorë, si dhe nga fondet e përbashkëta të disa njësive të qeverisjes vendore të krijuara sipas shkronjës “e” të nenit 10 të ligjit

nr.9244, datë 17.6. 2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;

d) veprimtarinë e përbashkët të dy ose më shumë ministrive në të njëjtën hapësirë të tokës bujqësore.

Në përfundim të këtij shqyrtimi, KSHMT-ja merr vendimet përkatëse, të cilat u njoftohen ministrive, institucioneve të tjera shtetërore, si dhe organeve të qeverisjes vendore.

3. KSHMT-ja shqyrton propozimet e organeve shtetërore dhe të strukturave pranë tyre për kalime dhe ndryshimet e gjendjes së tokave bujqësore, në zbatim të nenit 14 të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, si dhe mbrojtjen në tërësi të tokës bujqësore nga ndërtimet e paligjshme.

4. KSHMT-ja analizon raportin 6-mujor me të dhënat e raportuara nga Komisioni i Mbrojtjes së Tokës në qark, për gjendjen e masave mbrojtëse e rehabilituese të tokave bujqësore, bën vlerësimin për punën e kryer nga të gjitha strukturat shtetërore të ngarkuara për mbrojtjen e tokës bujqësore.

5. KSHMT-ja për çdo rast, kur vëren moszbatim të detyrimeve, që rrjedhin nga dispozitat e akteve ligjore e nënligjore, u propozon marrjen e masave administrative për strukturat e veçanta, që kanë përgjegjësi ligjore për mbrojtjen e tokës, organeve përkatëse që i kanë në varësi.

6. KSHMT-ja merr vendime të detyrueshme për zbatim nga organet e tjera shtetërore që ligji i ngarkon për mbrojtjen e tokës bujqësore edhe kur:

a) objekti i vendimit shtrihet për dy ose më shumë qarqe;

b) një komunë dhe/ose bashki parashtrohet vërejtje ose kundërshtime për vendimet që janë marrë nga këshilli i qarkut dhe KMT-ja në qark dhe që kanë si objekt masat mbrojtëse për tokën bujqësore, brenda territorit të komunës dhe/ose bashkisë përkatëse;

c) organi i qeverisjes vendore nuk ka nxjerrë vendimin e vet në kohën e përshtatshme e të përcaktuar në aktet nënligjore ose vendimi që është nxjerrë, nuk rezulton i plotë. Në këtë rast njoftohet organi përkatës, që ka për detyrë nxjerrjen e vendimit.

KREU II

INSPEKTORATI SHETETËROR I MBROJTJES SË TOKËS (ISHMT)

1. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit krijohet ISHMT-ja, për kontrollin e zbatimit të dispozitave të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në të gjithë territorin e vendit.

2. Inspektorati të kryesohet nga kryeinspektori dhe në përbërje të ketë specialistë me profesion agronom ose inxhinier gjeodet.

3. ISHMT-ja ushtron kontrole të programuara dhe të rastit për veprimtarinë që kryejnë Komisioni i Mbrojtjes së Tokës dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës në qarqe, si dhe strukturat e tjera shtetërore, të ngarkuara me ligj për zbatimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen e tokës.

4. ISHMT-ja bën vlerësimin e punës së kryer nga këto struktura dhe i propozon KSHMT-së masa për përmirësimin e gjendjes dhe masa disiplinore e administrative për struktura dhe titullarë, që nuk kanë përmbushur detyrimet, që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore për mbrojtjen e tokës.

Në përfundim të çdo kontrolli harton aktin e kontrollit, i cili u bëhet i njohur kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes së Tokës, kryetarit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës, kryetarëve të komunave dhe/ose bashkive ku është realizuar kontrolli.

5. ISHMT-ja grumbullon, përpunon dhe analizon të dhëna nga Komisioni i Mbrojtjes së Tokës dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës në qarqe, në bazë të të cilave përgatiten raportet 6-mujore dhe vjetore për KSHMT-në, si dhe raporte të veçanta për çështje konkrete, të kontrolluara drejtpërdrejt ose nëpërmjet Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

6. ISHMT-ja kontrollon mbajtjen e dokumentacionit teknik për mbrojtjen e tokës nga Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës dhe zërat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki.

7. ISHMT-ja bashkërendon punën, ndërmjet mbledhjeve të KSHMT-së, në fushën e veprimtarive për mbrojtjen e tokës dhe masave për rehabilitimin e tokave të dëmtuara, me struktura të tjera në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Ministrisë së Mjedisit, institucioneve të

tjera dhe organeve të qeverisjes vendore, të ngarkuara për mbrojtjen e tokës.

8. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, nëpërmjet ISHMT-së, ka në varësi teknike Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës në qark.

KREU III KOMISIONI I MBROJTJES SË TOKËS (KMT) NË QARK

1. KMT-ja në qark drejtohet nga kryetari i këshillit të qarkut.

Përgjegjësi i Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (SAMT) të qarkut është njëkohësisht edhe sekretar i KMT-së në qark.

2. KMT-ja thirret në mbledhje me njoftim të kryetarit, jo më pak se një herë në tre muaj, por, për çështje të veçanta, mund të mbledhet në çdo kohë.

3. Sekretari i KMT-së dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës në qark përgatisin dokumentacionin dhe materialet e mbledhjeve të KMT-së.

4. KMT-ja shqyrton dhe bashkërendon programet dhe projektet afatgjata, afatmesme dhe vjetore, që kanë si objekt:

a) përmirësimin e sistemit të kullimit dhe ujitjes në hapësirën e tokës bujqësore, që përfshihet brenda territorit të qarkut, kur me të lidhet veprimtaria e dy ose më shumë komunave dhe/ose bashkive;

b) përmirësimin e masave antierozive, nëpërmjet ndërtimit ose ngritjes së veprave të veçanta antierozive si pyllëzime, kanale të ujërave të larta, prita malore e vepra të tjera, kur këto përfshihen në hapësira të tokave bujqësore të dy ose më shumë komunave dhe/ose bashkive;

c) përmirësimin e masave mbrojtëse të brigjeve të lumenjve, rrjedha e të cilëve përshkon territorin e dy ose më shumë komunave dhe/ose bashkive.

Për të gjitha çështjet e shqyrtuara për bashkërendim, KMT-në qark merr vendime përkatëse, që i dërgohen në formë rekomandimi këshillit të qarkut dhe këshillave të komunave.

Këshilli i qarkut dhe këshillat e komunave dhe/ose bashkive, pasi i shqyrtojnë këto vendime, mund t'i kthejnë në vendime të tyre, të detyrueshme për zbatim.

5. KMT-ja shqyrton propozimet e njërive të qeverisjes vendore për përdorimin e tokës bujqësore për zhvillime të ndryshme urbane mbi këtë hapësirë, në zbatim të nenit 14 të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

6. KMT-ja analizon raportet e të dhënave 6-mujore të paraqitura nga zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, në komuna dhe/ose bashki dhe raportin e Seksionit të Administrimit të Mbrojtjes së Tokës për gjendjen, masat mbrojtëse dhe rehabilituese të tokës bujqësore, për të cilat merr edhe vendimet përkatëse.

7. KMT-ja përcakton çështjet e veçanta për masat mbrojtëse për tokën bujqësore, që do të verifikohen, kontrollohen ose studiohen nga grupet e kontrollit që krijojnë për këtë qëllim.

8. KMT-ja analizon, zbërthen dhe programon për qarkun vendimet e KSHMT-së, si dhe akte të tjera të ISHMT-së.

9. Të gjitha strukturat shtetërore, që funksionojnë dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut detyrohen që, në çdo kohë, të vënë në dispozicion të grupeve të kontrollit punonjësit apo specialistët e tyre, sipas programit të miratuar nga kryetari i këshillit të qarkut, në cilësinë e kryetarit të KMT-së në qark.

KREU IV INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TOKËS (IMT) NË QARK

1. IMT-ja organizohet si sektor i veçantë pranë Seksionit të Administrimit të Mbrojtjes së Tokës në qark.

Numri i punonjësve të IMT-së sipas qarqeve përcaktohet në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky numër të plotësohet, brenda muajit mars 2005, me specialistë me formim universitar në degët e agronomisë, gjeodezisë dhe ekonomisë.

2. Punonjësi i emëruar në IMT cilësohet inspektor dhe pajiset me kartën (certifikatën) e inspektorit, të nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit. Drejtimi i këtij inspektorati bëhet nga kryeinspektori.

3. IMT-ja ka varësi teknike nga ISHMT-ja, në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

4. IMT-ja programon punën vjetore të kontrollit të zbatimit të masave për mbrojtjen e tokës bujqësore, për të gjithë territorin e qarkut, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi dhe vendimeve të strukturave shtetërore, eprore, të mbrojtjes së tokës si KSHMT-së, ISHMT-së dhe KMT-së së qarkut.

5. IMT-ja programon dhe ushtron kontrolle:

a) metodike, të zakonshme, që organizohen dy herë në vit. Kontrolli i parë ushtrohet gjatë muajve prill-maj, ndërsa kontrolli i dytë në muajt shtator-tetor.

b) operative për çështje e territore të veçanta, të cilat organizohen në vijimësi nga IMT-ja ose grupe të veçanta të ngritura me vendim të KMT-së, për të cilat ndiqet e njëjta procedurë si për kontrollet metodike, të zakonshme.

6. Objekt kontrollit janë masat për mbrojtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësore, si dhe vendimet që janë marrë për to në periudhat pararendëse, për të gjitha komunat dhe/ose bashkitë në juridiksion të qarkut. Kontrolli bëhet në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

7. Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë ka për detyrë që grupit të kontrollit, për territorin përkatës, t’i caktojë si anëtarë specialistin e zyrës së menaxhimit të mbrojtjes së tokës dhe punonjës të tjerë të administratës së komunës/bashkisë, si dhe kryetarët e fshatrave dhe/ose administratorët e nënndarjeve të njëjësive administrative.

8. Në përfundim të kontrollit të të gjithë njësisë administrative, grupi i kontrollit harton aktin e kontrollit, ku përfshihen edhe të dhëna të tjera për kontrollin e ushtruar, përcakton detyrat dhe masat e veçanta që duhen marrë, të cilat ia paraqet kryetarit të komunës dhe/ose bashkisë së kontrolluar.

9. Raporti përmbledhës në shkallë qarku për kontrollin e ushtruar i paraqitet kryetarit të këshillit të qarkut. Ky raport analizohet në mbledhjen e radhës së KMT-së në qark. Pas shqyrtimit, për çdo çështje të veçantë, merren vendime përkatëse.

10. Në të gjitha kontrollet, që ushtrohen nga IMT-ja, zbatimi i sanksioneve ligjore, të përcaktuara në kreun V të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, dokumentohet nëpërmjet procesverbalit tip. Format i dhe mënyra e mbajtjes së procesverbalit tip, ndërmjet ushtruesve të kontrollit dhe subjektit të kontrolluar, miratohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

11. Grupet e kontrollit të IMT-së dhe grupet e veçanta të ngritura me vendim të KMT-së shoqërohen nga forcat e Policisë së Shtetit të drejtorisë së policisë së prefekturës përkatëse, si dhe nga Policia Ndërtimore, që ushtron veprimtari në territorin e qarkut, sa herë që vlerësohet nga kryetari i këshillit të qarkut, me cilësinë edhe të kryetarit të KMT-së.

Kryetari i këshillit të qarkut kërkesën për angazhimin e forcave të Policisë së Shtetit dhe të Policisë Ndërtimore, ua komunikon drejtuesve përkatës 3 ditë përpara fillimit të kontrollit.

12. IMT-ja mban regjistrin e mbrojtjes së tokës dhe dokumente të tjera, ku evidentohen treguesit thelbësorë për gjendjen dhe masat mbrojtëse për tokën bujqësore.

13. IMT-ja, në bazë të të dhënave që rezultojnë nga kontrollet e ushtruara dhe të treguesve të tjerë që merr nga zyrat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki, përgatit raportet përkatëse për KMT-në e qarkut, si dhe ISHMT-në në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

KREU V

1. Efektet financiare të zbatimit të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të këshillave të qarqeve, për vitin 2005, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet vendimit.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Mjedisit dhe institucione të

tjera të ngarkuara për mbrojtjen e tokës, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1
Numri i inspektorëve në IMT të qarqeve

Nr.	Emërtimi i qarkut	Nr. Inspektorët gjithsej
1	Berat	3
2	Dibër	3
3	Durrës	3
4	Elbasan	4
5	Fier	4
6	Gjirokastrë	3
7	Korçë	4
8	Kukës	3
9	Lezhë	3
10	Shkodër	3
11	Tiranë	3
12	Vlorë	4
	Republika	40

Lidhja nr.2
Financimi i shpenzimeve për mbrojtjen e tokës për vitin 2005

a	Emërtimi i institucioneve dhe i qarqeve	Gjithsej 000/lek	Nga kjo:			
			Personelit		Shpenzimet	
			Nr. punonj.	000/lek gjithsej	operative	kapitale
b		1 (3+4+5)	2	3	4	5
I	Për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit	4800	4	3500	1300	
II	Për këshillat e qarqeve (inspektorati i mbrojtjes së tokës), gjithsej ndarë sipas qarqeve	39 390	40	28 260	9930	1200
1	Berat	3110	3	2220	790	100
2	Dibër	3110	3	2220	790	100
3	Durrës	3110	3	2220	790	100
4	Elbasan	3800	4	2760	940	100
5	Fier	3800	4	2760	940	100
6	Gjirokastrë	3110	3	2220	790	100
7	Korçë	3110	3	2220	790	100
8	Kukës	3110	3	2210	790	100
9	Lezhë	3110	3	2220	790	100
10	Shkodër	3110	3	2220	790	100
11	Tiranë	3110	3	2220	790	100
12	Vlorë	3800	4	2760	940	100
	Totali (I+II)	44 190	44	31 760	11 230	1200

VENDIM
Nr. 81, datë 4.2.2005

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE PËR BASHKËPUNIMIN,
FINANCIAR DHE TEKNIK, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR
VITIN 2004, DHE TË AMENDAMENTEVE TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të bisedimeve për bashkëpunimin, financiar dhe teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për vitin 2004, dhe të amendamenteve të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**PROTOKOLLI I REZULTATEVE TË BISEDIMEVE PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR E
TEKNIK TË QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË DHE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2004**

Nga data 1 deri më 2 dhjetor 2004 në Tiranë u zhvilluan bisedimet midis delegacionit të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe delegacionit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar dhe teknik.

Delegacioni gjerman u kryesua nga z.dr.Rainer Goerdeler, nëndrejtor seksioni në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Drejtues i delegacionit shqiptar ishte zëvendësministri i Ekonomisë, z. Luan Shahollari.

Listat e pjesëmarrësve të të dy delegacioneve janë bashkëngjitur si shtojca.

Drejtuesi i delegacionit shqiptar përshëndeti miqtë gjermanë dhe shprehu vlerësimin më të lartë për bashkëpunimin e shkëlqyer me Republikën Federale të Gjermanisë në të gjitha fushat, si dhe falenderoi Qeverinë gjermane për mbështetjen që i jep Shqipërisë në procesin e zhvillimit të demokracisë dhe të ekonomisë së tregut gjatë këtyre 16 vjetëve të fundit.

Pala shqiptare vlerëson në mënyrë të veçantë iniciativat e Qeverisë gjermane, në kuadër të Paktit të Stabilitetit, për sensibilizimin e shteteve ekonomikisht të zhvilluara dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe institucional të Shqipërisë.

Kryetari i delegacionit shqiptar informoi se Shqipëria ka bërë hapa të reja për konsolidimin e demokracisë, sundimin e shtetit ligjor dhe përmirësimin e situatës ekonomike dhe integrimin e saj drejt strukturave europiane. Në këtë kontekst Qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë masash që synojnë krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat, krijimin e lehtësirave tregtare, mbajtjen nën kontroll të treguesve makroekonomikë dhe reformave të tjera ligjore e administrative.

Qeveria shqiptare beson dhe shpreson se edhe me bisedimet qeveritare të këtij viti Qeveria gjermane do të sigurojë nëpërmjet financimit të projekteve, konsulencës dhe eksperiencës së saj një mundësi më tepër për Shqipërinë për të përballuar sfidat që kemi përpara drejt integritimit në familjen e madhe europiane.

Përfaqësuesi i ambasadës gjermane falenderoi për sqarimet e hollësishme të drejtuesit të

delegacionit shqiptar në lidhje me stadin e zhvillimit politik dhe ekonomik në Shqipëri. Ai konfirmoi që qëllimi i bashkëpunimit dypalësh në Shqipëri konsiston në përafrimin me Bashkimin Europian. Ai bën të qartë që përafrimi është një synim ambicioz, që Shqipëria në këtë rrugë ka shënuar arritjet e saj, por që mbetet ende shumë për të bërë. Veçanërisht e rëndësishme është që ligjet të zbatohen, që zgjedhjet e ardhshme të vitit 2005 të zhvillohen sipas rregullave transparente dhe demokratike dhe që Qeveria shqiptare të vijojë luftën e saj kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Qeveria Federale është e gatshme që të mbështesë më tej Shqipërinë në procesin e reformave, kjo veçanërisht në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të energjisë, decentralizimit dhe të reformave ekonomike. Gjithashtu, ajo është e hapur për propozime nga sektorë të tjerë dhe përpiqet për një fleksibilitet sa më të madh të mundshëm. Në mënyrë të veçantë u theksuan zhvillimet pozitive në projektin e ujësjellësit Elbasan.

Drejtuksi i delegacionit gjerman falenderoi për përhëndetjen e përzemërt dhe shprehu kënaqësinë e tij për faktin që ai tashmë kishte mbajtur premtimin e tij dhënë para shumë kohësh për të vizituar Shqipërinë. Ai ndau të njëjtin opinion me zotin Shahollari, kryetarin e delegacionit shqiptar, për faktin që sektori privat në ekonominë shqiptare është zhvilluar mirë dhe solli në vëmendje bumin e ndërtimeve që kishte konstatuar gjatë rrugës nga aeroporti.

Në procesin e saj të transformimit që nga viti 1998, Shqipëria ka arritur rezultate për t'u vlerësuar. Ato duken sot në rritjen e qëndrueshme ekonomike, në normën e ulët të inflacionit dhe në stabilitetin monetar. Ai vuri theksin tek emri i mirë që ka bërë Shqipëria gjatë krizës kosovare si një faktor stabiliteti në rajon. Prova të raportit konstruktiv të Shqipërisë me fqinjët e saj janë eurorajoni i planifikuar në zonën e liqenit të Ohrit dhe të Prespës, si dhe bisedimet e suksesshme me Malin e Zimbi linjën 400 kV Tiranë-Podgoricë. Të dyja këto janë shembuj të një bashkëpunimi të mirë rajonal. Njëri prej tre qëllimeve kryesore të Paktit të Stabilitetit mbi ndërtimin e linjës Vienë-Athinë sikurse edhe eurorajoni do ta afrojnë Shqipërinë në mënyrë të dukshme me qëllimin tjetër të madh, përafrimin me Bashkimin Europian.

Ai deklaroi gatishmërinë e tij për të mbështetur vendin si në nivel dypalësh, ashtu edhe shumëpalësh. Një rëndësi në rritje kanë projektet PPP (public-private-partnership) për shkak të disponibilitetit në rënie të fondeve publike bilaterale. Projekti i Elbasanit duket se është konsoliduar pas kapërcimit të vështirësive dhe mund të shndërrohet në një shembull të mirë për përfshirjen e ekonomisë private.

Viti 2005 me zgjedhjet e tij parlamentare do të jetë vendimtar për Shqipërinë. Partnerët e Shqipërisë presin që zgjedhjet të përgatiten në mënyrë të kujdesshme dhe korrekte, të zhvillohen në mënyrë demokratike dhe korrekte. I rëndësishëm është fakti që rezultatet e zgjedhjeve të pranohen nga të tërë pjesëmarrësit dhe të mundësohet një kompozim i shpejtë i qeverisë. Kjo do t'i mundësonte Bashkimin Europian nënshkrimin e shpejtë të Marrëveshjes së Stabilizimit-Asocimit. Gjermania dhe Bashkimi Europian shpresojnë që Shqipëria deri në këtë moment të ketë treguar shenja të dukshme të zbatimit të deklaratave rreth qeverisjes së mirë, shtetit ligjor dhe luftës kundër korrupsionit. Për këtë qëllim ne dëshirojmë t'ju ndihmojmë me të gjitha instrumentet tona.

Pala shqiptare informoi lidhur me stadin e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit me Bashkimin Europian. Pala gjermane deklaroi se ajo vazhdon të jetë e gatshme të mbështesë procesin e përafrimit me Bashkimin Europian në kuadrin e bashkëpunimit financiar dhe teknik.

Të dyja palët ranë dakord që projektet brenda sektorëve të rëndësishëm të miratuara të kontribuojnë në përmirësimin e kuadrit shoqëror dhe ekonomik të Shqipërisë dhe në këtë mënyrë japin një ndihmesë të qenësishme për zhvillimin e mëtejshëm të vendit drejt Bashkimin Europian.

Të dyja palët mbështesin fushat kryesore të bashkëpunimit dypalësh: furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet e ujërave të zeza, reforma e energjisë dhe e ekonomisë/ndërtimi i ekonomisë së tregut, që nëpërmjet ndikimit të tyre në grupe të synuara të varfra japin një ndihmesë të veçantë politike zhvillimore për luftimin e varfërisë në kuadrin e Programit të Veprimit 2015 të Qeverisë Federale dhe SKZHES të Republikës së Shqipërisë.

Drejtuksi i delegacionit gjerman deklaroi se në kuadrin e buxhetit 2004 për projekte të bashkëpunimit financiar dhe teknik miratohen gjithsej si fonde të reja 15,250 milionë euro.

1. Bashkëpunimi financiar (BF)

1.1. Bashkëpunimi në vijim dhe aspekte themelore

Të dyja palët përshëndetën veprimtarinë e zyrës KfW, si një ndihmesë e të rëndësishme për intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit shqiptaro-gjerman.

1.1.1. Të përgjithshme

Të dyja palët ishin dakord për faktin se është e domosdoshme që koha administrative përgatitore për projektet e bashkëpunimit financiar të kufizohet në një minimum. Pikë të rëndësishme këtu janë përfundimi i shpejtë i marrëveshjeve qeveritare, kontratave të huave dhe të financimit, si dhe paraqitja në kohë e konfirmimeve ligjore përkatëse të domosdoshme. Në raste urgjente është mundur-si përjashtim nga rasti — edhe një parafinancim i aktiviteteve të projektit për të cilat janë nënshkruar kontratat e financimit me mjetet financiare të Fondit për Studime dhe Ekspertë.

1.1.2. Furnizimi me ujë dhe kanalizimi i ujërave të zeza

Pala gjermane përshendet miratimin e strategjisë kombëtare për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve nga Këshilli i Ministrave. Në këtë kuadër u theksua në mënyrë të veçantë rëndësia e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë, reduktimi i shpërdorimit të ujit, vazhdimësinë e decentralizimit dhe ngritja e tarifave në një nivel që do të mund të mbulonte shpenzimet. Masat janë në përputhje jo vetëm me përfytyrimet e donatorëve për reformat, por edhe me pohimet qendrore të dokumentit strategjik të pikave kyçe për bashkëpunimin gjermano-shqiptar. Të dyja palët janë të mendimit se konferenca e organizuar bashkërisht në pranverën e vitit 2004 ka rëndësi të madhe për rakordimin strategjik dhe për shkëmbimin e përvojës. Pala gjermane inkurajoi Qeverinë shqiptare që ta vazhdojë në mënyrë konsekuente rrugën e nisur për reformën e menaxhimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.

- Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Elbasan

Pala gjermane përshëndeti faktin se përpjekjet e përbashkëta të koncesionarit “Elber”, të *Berlinwasser International*, të qytetit të Elbasanit dhe të Qeverisë shqiptare kanë ndikuar në përmirësimin e ndjeshëm të gjendjes ekonomike shqetësuese të “Elber”-it. Vendimtare tani është që përpjekjet për rritjen e efikasitetit të pagesave të tarifave, të përshtatjes së tarifave të ujit dhe të reduktimit të humbjeve të tij të vazhdojnë në mënyrë të qëndrueshme. Projekti i investimeve që ka filluar mbështet këtë proces të rëndësishëm për sigurimin e vazhdimësisë. Paralelisht me këtë, pala gjermane i kërkon palës shqiptare të përpiqet për zbatimin e rritjes së tarifave, për të cilat është rënë dakord në kontratë dhe të aplikojë një zgjidhje për TVSH-në mbi faturat e paarkëtuara.

- Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Pogradec

Të dyja palët përshëndetën zhvillimet pozitive në Pogradec. Gjendja financiare e ndërmarrjes së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të zeza (U.K. Pogradec) është përmirësuar deri në atë masë sa janë përmbushur kushtet për vazhdimin e projektit të kanalizimeve të ujërave të zeza. Megjithatë, për sigurimin e këtyre përmirësimeve dhe për rritjen e vazhdimësisë janë të domosdoshme investime të tjera. Krahas fondeve të sapo riprogramuara prej 2,5 milionë euro (nga kanalizimet e ujërave të zeza në furnizimin me ujë), në kuadrin e fondeve të vitit 2004 do të vihen në dispozicion 2,5 milionë euro të tjera për furnizimin me ujë. Përveç kësaj, u vendos për shtimin e masës shoqëruese me 0,3 milionë euro.

Pala gjermane kërkoi që rezervatet e peshkut të domosdoshëm për ndërtimin e impiantit të pastrimit të ujërave të vihen në dispozicion të projektit sa më shpejt, për të shmangur vonesat në projekt.

- Kanalizimet e ujërave të zeza, Kavaja II

Pala gjermane theksoi me forcë se një zgjatje e mëtejshme e nënshkrimit të marrëveshjes së qeverisë mund të ketë pasoja për zbatimin e kontratave ekzistuese të ndërtimit dhe të shërbimeve. Pala shqiptare informoi palën gjermane se marrëveshja qeveritare do të nënshkruhet brenda muajit dhjetor 2004.

- Programi i furnizimit me ujë në Shqipërinë e Mesme (komponenti Berat-Kuçovë)

Meqenëse vënia në dispozicion e një koncesioni, siç ishte parashikuar për ndërmarrjet e ujit në Berat dhe Kuçovë nuk do të ishte ekonomikisht e përballueshme, duhet të kërkohen zgjidhje alternative për përmirësimin e furnizimit me ujë në të dy qytetet. Si hap i parë është parashikuar

zgjerrimi i programit për reduktimin e humbjeve, i përbërë fillimisht nga masat e emergjencës dhe vazhdimin e investimeve në ujësjellës-kanalizime për projektet e përgatitura nga konsulencia dhe të rëna dakord ndërmjet partnerëve.

- Programi i furnizimit me ujë

Ky program i planifikuar për bashkëpunimin e ardhshëm, ndodhet momentalisht në fazën e tij të konceptimit. Në gjysmën e parë të vitit 2005 duhet të fillojë një studim përgatitor. Fondi i vitit 2002 për projektin "Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Shqipërinë e Veriut" në shumën prej 5,0 milionë euro duhet të riprogramohet për programin e planifikuar. Pati një mirëkuptim në lidhje me faktin që në kuadër të programit të shqyrtohet marrja në konsideratë e projekteve të Bajram Currit.

- Menaxhimi i mbeturinave

Pas miratimit të vendit të depozitimit të mbeturinave nga "Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë" u bë i mundur përfundimi i studimit të bëshmerisë. Pala gjermane përsëritet vendosmërinë e bashkive të qarkut të Korçës (Pogradec) për ta çuar më përpara projektin dhe të krijojë kushte të tjera të nevojshme për zbatimin e projektit. Për shkak të domosdoshmërisë së eliminimit të organizuar të mbeturinave dhe të rezultateve pozitive të studimit të bëshmerisë, të dyja palët ranë dakord që ta ndjekin më tej projektin. Për këtë, në kuadrin e një këshillimi të mëtejshëm, duhet të mbështeten bashkitë për përmirësimin e kushteve institucionale dhe financiare. Masa do të financohet nga Fondi i Studimeve dhe Ekspertëve.

Masa për kualifikim në sektorin e ujësjellësit (fonde për kualifikim dhe specializim)

KfW-ja aktualisht verifikon raportin e ekspertëve hartuar para pak kohësh për një mbështetje të mundshme për projektin e Entit Rregullator të Ujërave.

1.1.3. Fusha e energjisë

Të dyja palët vlerësuan zhvillimin pozitiv të këtij sektori kyç të bashkëpunimit bilateral për zhvillim. Me rëndësi vendimtare për këtë sektor ishte zbatimi me përpikmëri i planit të veprimit për sektorin e energjisë elektrike, i miratuar me komunitetin ndërkombëtar të donatorëve, plan i cili para pak kohësh u shty deri në vitin 2006.

Përveç kësaj, pala gjermane vlerësoi qëndrimin konstruktiv të Shqipërisë në përgatitjet e deritanishme të projektit ndërkufitar për lidhjen e Shqipërisë me rrjetin europian të transmetimit të energjisë elektrike. Të dyja palët shohin në këtë projekt (Linja e transmetimit 400 kV të energjisë Tiranë-Podgoricë), marrëveshja e së cilës u nënshkrua në datën 18.11.2004, një projekt kyç i bashkëpunimit bilateral për zhvillim.

Përsa u përket kërkesave të larta të vazhdueshme për investime, si dhe hapave përpara në krijimin e një tregu rajonal për energjinë elektrike, Qeveria Federale është e gatshme të bashkëfinancojë projektet e reja në sektorin e energjisë në kuadër të bashkëpunimit financiar.

Mbështetja e efikasitetit të energjisë dhe energjive të rigjenerueshme

Të dyja palët do të shqyrtojnë gjatë përgatitjes së mëtejshme të projekteve, në ç'masë mund të zgjerohet volumi i mjeteve të disponueshme nëpërmjet një përzierjeje të mjeteve të bashkëpunimit financiar dhe fondeve të tregut ose me anë të një financimi të integruar të përbashkët.

Furnizimi me energji elektrike në jug të Shqipërisë

Nevoja e financimit për realizimin e komponentit Bistrica II është më e madhe se sa pritej fillimisht. Për këtë arsye, të dyja palët ranë dakord që financimin e këtij investimi ta sigurojnë nëpërmjet një financimi të përzier. Si pasojë, për komponentin Bistrica II do të përdoren fonde të mbetura nga fondet e miratuara në vitin 1999 (Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Korçë) në masën prej 1,79 milionë euro. Shuma e paketës së financimit arrin vlerën e 13.289 milionë euro (nga të cilat 10 milionë euro janë kredi koncesionare, 1.5 milionë euro dhe 1.789 milionë euro janë kredi e butë).

1.1.4. Reforma ekonomike / ndërtimi i ekonomisë së tregut FEDAD III

Projekti vë në dispozicion fonde të rifinancueshme dhe asistencë teknike për mikrofinancimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Pas një shqyrtimi të projektit, KfW-ja parashikon një nevojë komplete prej 10 milionë euro për 4 vitet e ardhshme. Si fazë e parë duhet të fillohet financimi me 2,81 milionë euro në vitin e ardhshëm.

1.1.5. Projekte të tjera

Planifikimi familjar

Pala gjermane përshëndeti faktin që u aplikua metoda e themelimit të organizatës së deritanishme zbatuese si një person i pavarur juridik. Në mënyrë që faza tjetër të fillojë sipas planifikimit në fillim të vitit 2005, është shumë i rëndësishëm nënshkrimi i shpejtë dhe hyrja në fuqi e marrëveshjes qeveritare dhe e kontratës së financimit dhe kontratës së projektit.

1.2. Projekte të reja

Shuma e përgjithshme e bashkëpunimit financiar të deritanishëm me Republikën e Shqipërisë kap vlerën më tepër se 250 milionë euro. Për vitin 2004, Republika Federate e Gjermanisë i jep Republikës së Shqipërisë një financim tjetër për zbatimin e projekteve të bashkëpunimit financiar në shumën 13 milionë euro. Me këto fonde do të realizohen projektet e mëposhtme:

1.2.1. Sektori i energjisë

(Mbështetja e efikasitetit të

energjisë dhe/ose energjiave të rigjenerueshme) 9,0 milionë euro (hua)

1.2.2. Shtesë mbrojtja e mjedisit në liqenin e Ohrit

(Komponentë furnizimi me ujë në Pogradec) 2,5 milionë euro (grant)

1.2.3. Shtesë masa shoqëruese

(Komponentë furnizimi me ujë në Pogradec) 0,3 milionë euro (grant)

1.2.4. Fondi i studimeve dhe i ekspertëve VI

1,2 milionë euro (grant)

Huaja jepet për një periudhë 40-vjeçare me një përqindje prej 0,75% në vit. Shlyerja e huasë mund të fillojë pas 10 vjetësh.

Përveç kësaj mund të akordohen paraprakisht në kuadrin e premtimeve të reja rreth 8.4 milionë euro për financimin e projekteve të mëtejshme në sektorin e ujërave dhe në sektorë të tjerë të rëndësishëm, me kusht dërgimin nëpërmjet kanaleve diplomatike të njoftimit zyrtar brenda vitit 2004.

Për të plotësuar instrumentet e deritanishme të financimit, KfW-ja për llogari të vet mund të vërë në dispozicion të institucioneve apo bizneseve shtetërore apo private, kredi financimi për mbështetjen e projekteve të rëndësishme për politikën dhe zhvillimit. Në qendër ndodhen si projekte të infrastrukturës ekonomike dhe sociale, ashtu dhe mbështetja e sektorit financiar. Në këtë kuadër KfW-ja vepron e ngarkuar posaçërisht nga Qeveria e Republikës Federate të Gjermanisë.

Për shkak të karakterit të projekteve që do të financohen, Shqipëria njeh rëndësinë për vënien në dispozicion në kohën dhe sasinë e mjaftueshme të valutës së këmbyeshme për shlyerjen e pakufizuar të borxhit (transferimi i valutës) përkundëjt KfW-së dhe të vazhdojë të përmbushë këtë kërkesë si deri tani duke respektuar afatet. Në këtë kuadër Shqipëria garanton të mos e vërë KfW-në në një pozicion më të disfavorshëm krahasuar me institucione financuese multilaterale.

1.3. Riprogramimet

Të dyja palët ranë dakord të integrojnë projektin "Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Shqipërinë e Veriut" në "Programin furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në veri të Shqipërisë" dhe fondin prej 5,0 milionë euro të miratuara në vitin 2002 ta riprogramojë në dobi të programit.

Për më tej, fonde të mbetura në masën prej 1 789 521,59 euro të miratuara në vitin 1999 për projektin "Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Korçë" të riprogramohen në dobi të projektit "Furnizimi me energji elektrike në jug të Shqipërisë (Komponenti Bistrica II)". Shuma e fondeve të miratuara nga fondet e bashkëpunimit financiar për këta komponentë arrin në këtë mënyrë gjithsej në masën 3 289 521,59 milionë euro.

1.4. Bashkëpunimi i ardhshëm

Në kuadër të çështjeve kyçe të bashkëpunimit u ra dakord që ky i fundit të vazhdojë për këto fusha projekte:

- Mikrofinancimet / Mbështetja e SME-ve

- Programi i financimit në sektorin e ujit (Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet e ujërave të zeza)

- Menaxhimi i mbetjeve

Në sektorin kyç të energjisë, të dyja palët synojnë një vazhdim dhe intensifikim të

mëtejshëm të bashkëpunimit të suksesshëm. Krahas projekteve të reja për mbështetjen e efikasitetit të energjisë dhe të energjive të rigjenerueshme — të dyja palët janë dakord të vazhdojnë bashkëpunimin në mënyrë të veçantë në fushën e transmetimit të rrymës elektrike. Me interes të veçantë janë projektet ndërkuftare për transmetimin e rrymës elektrike.

Këto projekte duhet të përgatiten nëpërmjet ekspertëve dhe / ose nëpërmjet studimeve të bëshmërisë.

1.5. Projekti i DEG-së: Programi gjermano-shqiptar për krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Të dyja palët ranë dakord që programi të përfundojë më 31.12.2004.

2. Bashkëpunimi teknik

2.1. Bashkëpunimi teknik në vazhdim

Të dyja palët u shprehën të kënaqura me zbatimin e deritanishëm të projekteve aktuale në vazhdim. Në veçanti u diskutuan pikat e mëposhtme:

2.2. Përafrimi i Shqipërisë me Bashkimin Europian

Pala gjermane ndjek me interes negociatat ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe njeh saktë vështirësitë që ka Shqipëria në procesin e përqasjes me Bashkimin Europian. Ajo shprehu gatishmërinë e saj të mbështesë partnerët shqiptarë në kuadër të bashkëpunimit teknik, veçanërisht në marrjen përsipër të *Aquis Communautaire*.

Zhvillimi i strategjisë sektoriale për turizmin

Me mbështetjen gjermane, para pak kohësh Qeveria shqiptare hartoi dhe miratoi një koncept për turizmin. Qëllimi kryesor në zbatimin e saj është tërheqja e investimeve private, në mënyrë të veçantë nga jashtë. Të dyja palët ranë dakord që fondi i mbetur prej gati 50 000 euro, të përdoret për mbështetjen e investimeve. Konkretisht duhen hartuar ekspozë investitorësh për projekte të ndryshme turizmi dhe duhet mbështetur Agjencia për Nxitjen e Investimeve të Huaja në identifikimin e investitorëve.

Mbështetja e ekonomisë private në rajonin Korçë/Pogradec

Projekti u zgjat me fondet e mbetura deri më 30.9.2005. Këtu, ndërmjet të tjerave, duhet të aktualizohet në bashkëpunim me Agjencinë e Nxitjes së Eksporteve strategjia për nxitjen e eksporteve, e mbështetur nga pala gjermane në vitin 2001.

Mbështetja rajonale për ekonominë e punësimit në rrethet me struktura të dobëta në veri të Shqipërisë nëpërmjet masave për reduktimin e varfërisë

Ky projekt mbështet procesin e decentralizimit, nxit ekonominë lokale dhe përfaqësimin e interesave të saj, forcon strukturat rajonale për një zhvillim të vazhdueshëm dhe mbështet bashkëpunimin ndërkuftar me vendet fqinje. Nëpërmjet iniciativave të vogla të shumëllojshme nxitet ekonomia lokale. Të dyja palët shprehën kënaqësinë për projektin dhe ranë dakord për vënien në dispozicion të fondeve të tjera të BT në vitin 2004.

Mbështetja e Ministrisë së Financave në fusha të përzgjedhura

Më dëshirë të Ministrisë së Financave, pala gjermane u shpreh e gatshme ta mbështesë atë në kuadrin e këtij projekti për hartimin e një raporti vjetor. Ka mirëkuptim të përbashkët që raporti të përgatitet nga ekspertë shqiptarë.

Mbështetja komunale e bizneseve në Bashkinë e Tiranës

Pala gjermane i përgjigjet kërkesës së Qeverisë shqiptare për mbështetjen e Bashkisë së Tiranës si qendër ekonomike. Ajo do të përpiqet të organizojë një partneritet me një qytet gjerman për të siguruar një transferim të kualifikuar dijesh.

2.3. Projekte të reja

Shuma e përgjithshme e bashkëpunimit teknik të deritanishëm me Republikën e Shqipërisë kap shifrën rreth 88 milionë euro. Për vitin 2004, Republika Federale e Gjermanisë i jep Republikës së Shqipërisë një grant tjetër për zbatimin e projekteve të bashkëpunimit teknik në shifrën 2,250 milionë euro.

2.3.1. Përdorimi i mjeteve financiare

Të dy delegacionet janë të mendimit që shuma (pika 2.3) të përdoret për projektet e mëposhtme:

Mbështetja rajonale për ekonominë e

punësimin në rrethet me struktura të

dobëta të Shqipërisë së Veriut, faza e dytë 1,00 milion euro

Mbështetja komuna e bizneseve në Bashkinë e Tiranës 0.50 milion euro

Shtesë fondi i studimeve dhe ekspertëve (SFF) 0,75 milion euro

Në fondin SFF janë ende të papërdorura rreth 450 000 euro së bashku me fondet e reja, ky fond disponon mbi 1,2 milionë euro, të cilat duhet të përdoren për masat e mëposhtme:

- Këshilli i Shoqatës së Ndërmarrjeve të Ujësjiellës-Kanalizimeve, faza e dytë;

- Eurorajoni i liqenit të Prespës dhe të Ohrit - Zhvillimi rajonal ndërkufitar, pjesa shqiptare e bashkëpunimit ndërrajonal me Qeverinë maqedonase;

- Mbështetje e mëtejshme për Ministrinë e Ekonomisë;

- Masa për konsolidimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja;

- Mbështetje e hershme e fëmijëve handikapatë;

- Zhvillimi i mëtejshëm i koncepteve për ndërtimin e dy parqeve në Tiranë.

2.4. Bashkëpunimi i ardhshëm

Të dy delegacionet ranë dakord që në të ardhmen të marrin në konsideratë fushat e mëposhtme për këshillim e asistencë në kuadër të bashkëpunimit teknik:

- Modernizimi i kadastrës së qytetit të Tiranës;

- Mbështetje në procesin e përfaqësimit me Bashkimin Europian;

- Shtesë për fondin e studimeve dhe ekspertëve;

- Masa mbështetëse për persona handikapatë nëpërmjet integritit të tyre në ekonomi e shoqëri, si dhe

- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme për Metrologjinë dhe Kalibrimin;

- Mbështetje për rishikimin e legjisllacionit ekonomik.

3. Forma të tjera të bashkëpunimit teknik

3.1. Ekspertë të integruar

Delegacioni gjerman theksoi se Republika Federale është e gatshme të ndihmojë Shqipërinë në përpjekjet e saj për të mbuluar nevojat për ekspertë në ato fusha me rëndësi për nga pikëpamja e politikave për zhvillim, ku mungojnë ekspertë vendas. Në këtë kuadër, qeveria federale mund të asistojë për gjetjen e ekspertëve të përshtatshëm në tregun gjerman të punës dhe t'u sigurojë atyre plotësimin e pagave në kuadrin e mundësive të veta financiare.

Aktualisht ndodhen në Shqipëri tre ekspertë të integruar. Ndërmjetësimi për gjetjen e ekspertëve në të ardhmen do të përqendrohet kryesisht në pikat kyçe të vendosura nga të dy qeveritë.

Kërkesat për ekspertë të integruar mund t'i paraqiten "Qendrës për migrim ndërkombëtar e zhvillim (CIM)" Barckhausstr. 16, D-60325 Frankfurt/M, nëpërmjet ambasadës gjermane. CIM është i gatshëm të pranojë kërkesa nga partnerët shqiptarë dhe t'i shqyrtojë ato me dashamirësi.

3.2. Formimi politik-shoqëror

Delegacioni gjerman vuri në dukje se aktualisht fondacioni Fridrich-Ebert, ai Konrad Adenauer dhe Hans-Seidel vazhdojnë të veprojnë në Shqipëri të mbështetur financiarisht nga Qeveria Federale. Përveç kësaj, Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shoqatës së Shkollave të Larta të Gjermanisë realizon masa mbështetëse për arsimimin e të rriturve.

3.3. Puna e qendrave kishtare

Kryesuesi i delegacionit gjerman informoi se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë mbështet financiarisht dhe bashkëpunimin për zhvillim të strukturave gjermane kishtare në Shqipëri.

3.4. Vizitat këshilluese të shërbimit të ekspertëve në pension (Senior-Experten Service) (SES)

Pala gjermane informoi lidhur me veprimtarinë e SES-së të mbështetur nga Qeveria Federale. Pikë kyçe e këshillimit nëpërmjet ekspertëve në pension momentalisht është eliminimi i problemeve akute të natyrës teknike dhe/ose ekonomiko-menaxhuese të bizneseve të vogla e të mesme.

3.5. InWent mbështet reformat ekonomike dhe shoqërore në Shqipëri përmes dialogut dhe trajnimit ndërkufitar, përfaqësimin me strukturat europiane dhe ndërtimin e ekonomisë së tregut. Në

këtë kuadër aktivitetet e InWent përqendrohen në tema të tilla si teknologji mjedisore inovative, formim profesional orientuar për nga mundësitë e punësimit, konsolidimi i organizatave dhe shoqatave ekonomike, mbështetje e ekonomisë komunale dhe rajonale, si dhe ndërtimi i strukturave dhe institucioneve të decentralizuara në zonat rurale.

Për vitet në vijim synohet një lidhje më e fuqishme e sektorëve prioritarë me qëllim mbështetjen e një zhvillimi të integruar rajonal të ekonomisë në Shqipëri.

4. Kushtet për zbatimin e projekteve

Të dy delegacionet janë të mendimit se të gjitha shërbimet e parashikuara në këtë protokoll (në pikat 1 dhe 2) mund të realizohen nga pala gjermane vetëm pasi:

- Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë të ketë marrë një vendim pozitiv pas projekteve/programeve të vlerësimit nëpërmjet Bankës për Rindërtim (KfW) dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GTZ) dhe/ose një organizimi tjetër të ngarkuar me zbatimin e projekteve;

- të jetë siguruar financimi i plotë i projektit të programit;

- të kenë hyrë në fuqi marrëveshjet ndërkombëtare ende të palidhura (marrëveshje qeveritare dhe marrëveshjet për projekte), kontratat e financimit apo kredihënies, si dhe marrëveshjet e zbatimit me KM/-në, GTZ-në dhe të tjera organizma zbatuese, nëse ka të tilla.

5. Klauzolë

- Pala gjermane tërheq vëmendjen në mënyrë të veçantë lidhur me faktin se projektet për bashkëpunim financiar (pika 1) dhe të bashkëpunimit teknik (pika 2) shfuqizohen pa rinovim, nëse 8 vjet pas vitit të miratimit të projektit nuk janë përfunduar marrëveshjet për zbatim d.m.th. kontratat e financimit/huadhënies në rastin e bashkëpunimit financiar dhe shkëmbimi i notave në rastin e bashkëpunimit teknik. Për projektet e vitit 2004 ky afat përfundon më 31.12.2012.

- Nëse një ose disa prej projekteve të përmendura nuk zbatohen apo zbatohen pjesërisht, atëherë ai/ato mund të zëvendësohen me një apo disa projekte të tjera në marrëveshje ndërmjet të dy palëve.

6. Deklaratë

- Pala gjermane përshendet masat e marra nga Qeveria shqiptare për luftën kundër korrupsionit. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë shprehin të njëjtin vlerësim se korrupsioni dëmton qeverisjen e mirë, shpërdoron mjetet financiare dhe ka efekte të gjera negative si në zhvillimet ekonomike dhe ato sociale. Ai rrezikon besueshmërinë e bashkëpunimit për zhvillim, mbështetjen e tij nga opinioni publik dhe prek përpjekjet e të gjithë atyre që punojnë për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Korrupsioni pengon konkurrencën e hapur dhe transparente, ndër të tjera edhe konkurrencën që synon çmim e cilësi.

Të dy qeveritë do të punojnë ngushtë me njëra-tjetrën për të garantuar transparencë, llogaridhënie dhe integritet për përdorimin e mjeteve publike financiare dhe për të shmangur mundësitë për veprime të korruptuara në bashkëpunimin e tyre për zhvillim.

Qeveria gjermane përshendet iniciativën e Qeverisë shqiptare në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Ratifikimi i Protokollit të Palermos, caktimi i një koordinatori ligjor, si dhe plani kombëtar i veprimit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore dhe të iniciativave të tjera rajonale shihen si hapat e parë të rëndësishëm për të luftuar me këmbëngulje trafikimin ndërkombëtar të qenieve njerëzore, si dhe për të garantuar standardet e të drejtave të njeriut në mbrojtje të viktimave. Qeveria gjermane shpreson që realizimi i planit kombëtar të veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore do të çohet fuqishëm përpara.

Të dy delegacionet ranë dakord që konsultimet dhe bisedimet e ardhshme qeveritare për vitin 2005 të kryhen në Tiranë. Afatet do të përcaktohen më vonë.

Ky protokoll është hartuar në gjuhën shqipe e atë gjermane.

Ky protokoll hyn në fuqi, pasi pala shqiptare të vërë në dijeni palën gjermane me anë të një note verbale, lidhur me përfundimin e procedurave ligjore për miratimin e tij.

Tiranë, 2 dhjetor 2004

Për delegacionin e Qeverisë së Republikës
Federale të Gjermanisë
Dr.Rainer Goerdeler

Për delegacionin e Këshillit të Ministrave të
Republikës së Shqipërisë
Z.Luan Shahollari

VENDIM
Nr. 84, datë 11.2.2005

PËR KRIJIMIN E ENTIT TË TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Entit të Turizmit, si person juridik, publik, me seli në Tiranë, me financim nga Buxheti i Shtetit, në varësi të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, që ushtron veprimtari shtetërore në fushën e turizmit. Emërtimi i shkurtuar i agjencisë është ET.

2. Enti i Turizmit ka për objekt të veprimtarisë:

a) promovimin dhe krijimin e identitetit të turizmit shqiptar, nëpërmjet shfrytëzimit të të gjithë potencialit ekzistues turistik të vendit;

b) realizimin e planifikimit për zhvillimin e turizmit, bashkërendimin e programeve të investimeve publike në zhvillimin e infrastrukturës së përgjithshme, në kuadër të politikave të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, si dhe monitorimin e këtij zhvillimi;

c) zbatimin e masave me karakter ligjor dhe institucional në administrimin e territorit në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, të parashikuara në strategjinë e zhvillimit të turizmit;

ç) publikimin e projekteve, masterplaneve, studimeve turistike dhe të legjislacionit të turizmit në publik për nxitjen e investimeve në fushën e turizmit;

d) monitorimin, ndjekjen e veprimtarive të stimuluar dhe zbatimin e marrëveshjes së qirasë, në përputhje me ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”;

dh) zhvillimin dhe mbajtjen e statistikave të turizmit nëpërmjet mbledhjes, hartimit dhe raportimit të të dhënave statistikore për turizmin. Monitorimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave për turizmin, në formën e një sistemi informativ të menaxhimit të turizmit;

e) promovimin e turizmit shqiptar, brenda dhe jashtë vendit, për krijimin e një pamjeje pozitive dhe për përfshirjen e Shqipërisë në tregun turistik ndërkombëtar;

ë) realizimin e marketingut dhe të promovimit në nivel kombëtar, bashkërendimin dhe mbështetjen e veprimtarive rajonale të marketingut, përfaqësimin në panaire dhe ekspozita turistike, kombëtare dhe ndërkombëtare, prodhimin e materialeve promovionale;

f) bashkëpunimin me institucione publike, financiare, me shoqata të biznesit e të investitorëve dhe me organizata turistike të specializuara, ndërkombëtare, për zhvillimin e biznesit të turizmit dhe përgatitjen e programeve përkatëse të trajnimit;

g) bashkërendimin me zyrat rajonale turistike dhe të përfaqësive turistike të entit, brenda dhe jashtë vendit, si dhe dhënien e asistencës për autoritetet vendore dhe personat, juridikë ose fizikë, veprimtaria e të cilëve synon promovimin e turizmit vendor a kombëtar.

3. Organet drejtuese të Entit të Turizmit janë Drejtori i Përgjithshëm dhe bordi këshillues.

4. Drejtori i Përgjithshëm emërohet me konkurrim të hapur, lirohet ose shkarkohet nga ministri që mbulon fushën e turizmit, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Drejtori i Përgjithshëm ka këto të drejta dhe detyra:

a) Drejton dhe administron të gjithë veprimtarinë e Entit të Turizmit dhe përgjigjet para ministrit që mbulon fushën e turizmit;

b) Harton rregulloren e brendshme të veprimtarisë së Entit dhe ia paraqet për miratim ministrit që mbulon fushën e turizmit;

c) Bashkërendon punën për hartimin e projektbuxhetit, sipas rregullave dhe afateve, që përcakton ligji organik për Buxhetin e Shtetit, dhe ia paraqet për miratim ministrit që mbulon fushën e turizmit, pasi ka marrë edhe mendimin e bordit këshillues;

ç) Propozon programin vjetor të veprimtarive të entit dhe e paraqet për miratim te ministri që mbulon fushën e turizmit;

d) I paraqet për miratim bordit këshillues buxhetin dhe programin e punës, para fillimit të çdo veprimtarie për përmbushjen dhe realizimin e programit;

dh) Përgjigjet për shpenzimet e bëra nga buxheti i entit, në përputhje me objektivat dhe qëllimin e funksionimit të tij;

e) Bashkërendon punën me bordin këshillues për zbatimin me sukses të strategjisë së qeverisë në fushën e turizmit;

ë) Përgjigjet për veprimtarinë e entit për përmirësimin dhe rritjen e imazhit të Shqipërisë në fushën e promovimit turistik;

f) Përfaqëson Entin në marrëdhënie me të tretët, në përputhje me rregulloren e brendshme të tij, e cila miratohet nga ministri që mbulon fushën e turizmit;

g) Krijon, zhvillon dhe ruan lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të organizatave të biznesit dhe të institucioneve publike;

gj) Garanton cilësinë e materialeve informuese dhe promovuese dhe shpërndarjen e tyre në kohë pranë subjekteve, publike dhe private, të interesuara;

j) Emëron dhe liron nga detyra nëpunësit e Entit, në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil.

5. Drejtori i Përgjithshëm lirohet ose shkarkohet nga detyra nga ministri që mbulon fushën e turizmit, sipas procedurave të parashikuara në aktet nënligjore në fuqi, kur:

a) mbush moshën e pensionit;

b) emërohet në një detyrë tjetër;

c) nuk arrin rezultatet konkrete në punë dhe për drejtim të dobët të Entit;

ç) shpallet nga gjykata, me vendim të formës së prerë, fajtor për kryerjen e veprave penale;

d) vepron në kundërshtim me programin dhe objektivat e veprimtarisë së Entit;

dh) bëhet i paafte fizikisht a mendërisht.

6. Bordi këshillues përbëhet nga:

- 1 përfaqësues nga ministria që mbulon fushën e turizmit;

- 1 përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë;

- 1 përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

- 1 përfaqësues nga Ministria e Mjedisit;

- 1 përfaqësues nga shoqatat e hotelerisë;

- 1 përfaqësues nga shoqatat e agjencive turistike;

- 1 përfaqësues nga shoqatat ambientaliste.

Kryetar i bordit këshillues të ET-së është Drejtori i Përgjithshëm i Entit. Përbërja e bordit miratohet me urdhër të ministrit që mbulon fushën e turizmit.

Bordi këshillues i Entit të Turizmit shqyrton dhe ndjek:

a) programet e promovimit të turizmit shqiptar, brenda dhe jashtë vendit;

b) programet e përfaqësimit të turizmit shqiptar në panairë dhe ekspozita të ndryshme;

c) hartimin e programeve për organizimin e veprimtarive të biznesit për promovimin dhe shërbimet turistike;

ç) marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të vendit dhe të huaja;

d) problemet që lidhen me studimet turistike dhe investimet në fushën e turizmit;

dh) problemet që dalin gjatë realizimit të veprimtarisë.

Bordi mblidhet në mënyrë periodike, një herë në dy muaj.

Mbledhja thirret nga kryetari i tij. Anëtarët njoftohen me shkrim 15 ditë para zhvillimit të

mbledhjes, të cilëve u dërgohen edhe materialet për çështjet, që do të merren në shqyrtim. Për çdo mbledhje, anëtarët shpërblehen me 5000 (pesë mijë) lekë nga buxheti i ET-së.

7. Struktura dhe organizimi i Entit të Turizmit përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit që mbulon fushën e turizmit.

8. Niveli i pagave të punonjësve të Entit të Turizmit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kriteret e marrjes në punë të personelit të Entit dhe përshkrimi i vendeve të punës përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Entit të Turizmit.

9. Enti i Turizmit financohet nga Buxheti i Shtetit. Enti nuk mund të kryejë veprimtari të tjera, jashtë objektit të veprimtarisë së përcaktuar në këtë vendim, në rregulloren e brendshme dhe në programin vjetor të veprimtarisë. Fondet financiare nuk mund të përdoren, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për qëllime të tjera.

10. Viti financiar i Entit të Turizmit fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor. Për çdo vit financiar hartohet bilanci ekonomiko-financiar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Drejtori i Përgjithshëm paraqet për shqyrtim dhe miratim në ministrinë që mbulon fushën e turizmit, bilancin e vitit pasardhës.

11. Struktura e auditimit e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit kontrollon veprimtarinë ekonomiko-financiare të Entit të Turizmit dhe certifikimi i bilancit bëhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, sipas ligjeve në fuqi.

12. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 85, datë 11.2.2005

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCESION, TË FORMËS “BOO”,
TË NJË SIPËRFAQEJE PËRRETH FABRIKËS SË ÇIMENTOS, FUSHË-KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Fillimin e procedurës së dhënies me koncesion, të formës “BOO” (Ndërtim-pronësi-shfrytëzim), të një sipërfaqeje prej 16 ha, përreth fabrikës së çimentos, Fushë-Krujë, shoqërisë “Fushë-Krujë Cement Factory” sh.p.k., si propozim i pakërkuar, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA) për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së koncesionit të jenë Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit.

3. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



VENDIM
Nr. 86, datë 11.2.2005

KRIJIMIN E KOMITETEVE TË MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 17 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Të përgjithshme

1. Komitetet e menaxhimit krijohen vetëm për zonat e mbrojtura Park Kombëtar, Rezervat Natyror i Menaxhuar dhe Peizazh i Mbrojtur (kategoritë II, IV dhe V të zonave të mbrojtura).
2. Komitetet e menaxhimit organizohen në nivel vendor dhe ndjekin zbatimin e planeve të menaxhimit për zonat ku ngrihen.
3. Komitetet e menaxhimit mbikëqyrin edhe monumentet e natyrës, që ndodhen në qarkun ose qarqet ku shtrihet zona e mbrojtur që ata menaxhojnë.

II. Përbërja e komiteteve të menaxhimit

1. Komitetet e menaxhimit përbëhen nga përfaqësues të institucioneve publike dhe jopublike, ku ndodhet zona e mbrojtur, dhe konkretisht nga:
 - a) përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit;
 - b) përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave;
 - c) përfaqësuesi i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit;
 - ç) përfaqësuesi i bashkisë ose i bashkive, në territorin e të cilave shtrihet zona e mbrojtur;
 - d) kryetarët e komunave, në territorin e të cilave shtrihet zona e mbrojtur;
 - dh) përfaqësuesi i këshillit të qarkut ose të qarqeve, ku shtrihet zona e mbrojtur;
 - e) përfaqësuesi i prefekturës ose i prefekturave, ku shtrihet zona e mbrojtur;
 - ë) përfaqësuesi i Agjencisë Rajonale të Mjedisit të qarkut, ku shtrihet pjesa më e madhe e zonës;
 - f) drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor në zonë;
 - g) përfaqësuesi i pronarëve të tokave, kur në territorin e zonës së mbrojtur ka toka private;
 - gj) përfaqësuesi i organizatave jofitimprurëse, në nivel kombëtar ose vendor, aktive për problemet e zonës së mbrojtur;
 - h) anëtarë të tjerë.

Kryetar i komitetit të menaxhimit është përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit.

2. Ministri i Mjedisit, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, u kërkon drejtuesve të institucioneve të përmendura në pikën 1, të caktojnë zyrtarisht përfaqësuesit e tyre dhe miraton përbërjen emërore të secilit komitet menaxhimi.

3. Administrata e zonës së mbrojtur luan edhe rolin e sekretarisë teknike të komitetit të menaxhimit dhe ka për detyrë:

- a) të përgatisë materialet për mbledhjen e komitetit të menaxhimit;
- b) të njoftojë anëtarët për mbledhjen e radhës;
- c) të mbajë protokollin e mbledhjes;
- ç) të përgatisë raportin dyvjeçar të gjendjes së zonës së mbrojtur.

III. Organizimi dhe funksionimi i komitetit të menaxhimit

1. Komiteti i menaxhimit e ushtron veprimtarinë nëpërmjet mbledhjeve të zakonshme, të cilat janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve.
2. Komiteti i menaxhimit mblidhet jo më rrallë se dy herë në vit.

3. Mbledhjet e komitetit të menaxhimit janë të hapura.

IV. Përgjegjësitë dhe detyrat e komitetit të menaxhimit

1. Komiteti i menaxhimit është përgjegjës për administrimin dhe mbrojtjen e zonës, përgjegjësi të cilën e përmbush duke ndjekur:

a) zbatimin e planit të menaxhimit të zonës dhe të programeve që hartohen në mënyrë të hollësishme sipas kërkesave të tij;

b) zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore nga administratat e zonave të mbrojtura dhe nga subjektet, që e ushtrojnë veprimtarinë në zonë;

c) ruajtjen e cilësisë së zonës dhe nxitjen e zhvillimit ekologjik të mjedisve përreth saj;

ç) zbatimin e kërkesave për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të zonës.

2. Komiteti i menaxhimit ka për detyrë:

a) të kontribuojë në hartimin e planit të menaxhimit të zonës, të sigurojë përputhshmërinë e tij me strategjinë dhe planet vendore e sektoriale të zhvillimit, duke u kujdesur që këto të fundit të respektojnë kërkesat për mbrojtjen e zonës;

b) të organizojë, monitorojë zbatimin e planit të menaxhimit të zonës dhe të veprimtarive të licencuara, që zhvillohen në të;

c) të japë mendim për kërkesat për përdorimin e burimeve natyrore të zonës, si dhe për pajisjen me leje mjedisore për veprimtaritë që do të ushtrohen në të;

ç) të miratojë elementet e hollësishme të kërkesave për lidhjen dhe zbatimin e kontratave nga administrata e zonës me subjektet private e shtetërore, vendase apo të huaja, për ushtrimin e veprimtarive në këtë zonë, kundrejt pagesave përkatëse;

d) të analizojë kryerjen e detyrave dhe të funksioneve të administratës së zonave të mbrojtura;

dh) të analizojë raportin për të ardhurat dhe shpenzimet financiare dhe të përcaktojë drejtimin e investimeve në zonë;

e) të miratojë rregulloret e hartuara nga administrata e zonës së mbrojtur që garantojnë ruajtjen, përdorimin dhe administrimin e saj;

ë) të miratojë raportin dyvjeçar të gjendjes së zonës së mbrojtur, i cili publikohet 2 muaj pas miratimit;

f) t'i propozojë Ministrin të Mjedisit, në bazë të studimeve të kryera, ndryshime në planin e menaxhimit të zonës, zgjerimin e kufijve, si dhe masa shtesë për përmirësimin e cilësive të saj;

g) të shqyrtojë ankesat e pronarëve dhe të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari në zonë, ndaj veprimeve të administratës së zonës;

gj) t'u kërkojë organeve përkatëse ndalimin e zbatimit të projekteve dhe të veprimtarive, që edhe pse zhvillohen jashtë zonës, kanë ndikim negativ në të apo bien ndesh me planin e menaxhimit të saj;

h) të kërkojë nga kryeinspektori i mjedisit kontrollë në veprimtaritë, që ushtrohen në zonë dhe përreth saj, për të zbutur dhe shmangur ndikimet negative në të;

i) të nxisë hartimin dhe zbatimin e projekteve për përmirësimin e cilësive të zonës;

j) të bashkërendojë veprimtaritë me këshillin e basenit përkatës, me të cilin të shkëmbejë vazhdimisht të dhëna;

k) të bashkëpunojë me Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit për promovimin e zonave të mbrojtura edhe si zona me interes turistik.

3. Ngarkohen Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 87, datë 11.2.2005

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR
KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**


Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë vijojnë:

1. Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar t’i shtohen dhe “10 km” rrugë.
 2. Në lidhjen 1, “Rrjeti rrugor kombëtar”, që i bashkëlidhet vendimit, shtohet emërtimi:
“Drejtoreisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Fier, Fier-Kraps-Lalar 10 km rrugë interurbane, dytësore”.
 3. Në tabelën “Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale”, që i bashkëlidhet vendimit, hiqet emërtimi “Fier-Kraps-Lalar”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



Rr. Nac. Drej. Fier, Rrugëve

Rr. Rurale Regionale c. Rrethit Qendror Fier

VENDIM
Nr. 93, datë 11.2.2005

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.310, DATË 14.5.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE,
TË CILAT DO TË RUHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PAS LIRIMIT
NGA FUNKSIONI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.422, DATË 12.9.2002 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E
PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë“, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1 të vendimit nr.310, datë 14.5.2004 të Këshillit të Ministrave shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ruhet dhe mbrohet nga Garda e Republikës së Shqipërisë edhe një vit pas lirimit nga funksioni.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

URDHËR
Nr. 9685, datë 23.12.2004

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR.2152, DATË 2.4.2002 “PËR PËRCAKTIMIN E
FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E FITUESIT PËR LOJËRAT E FATIT,
KËRKESA PËR DREJTUESIT DHE PERSONELIN KRYESOR TË SHOQËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet” dhe në zbatim të kreut I pika ç të vendimit nr.238, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, Ministri i Financave

URDHËRON:

1. Në pikën 2, kreu III germa “b” e urdhrit nr.2152 datë 2.4.2002 ndryshon si më poshtë:
“Llotari të çastit: Fondi i ngurtësimit për llotaritë e çastit të jetë në masën 20% të çmimeve të ofruara për fituesit e llotarisë, por jo më i madh se 5 milionë lekë për çdo llotari të organizuar. Ky fond mund të çngurtësohet vetëm pas përfundimit të lojës.”.
2. Në pikën 2, kreu II i urdhrit nr.2152, datë 2.4.2002, ndryshon si më poshtë vijon:
“Lojërat e fatit sportive: Fondi i ngurtësimit për lojërat e fatit sportive, kategoria “basti” të jetë në masën 20 milionë lekë dhe për kategorinë “konkurs për parashikimet sportive fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 milion lekë.”.
3. Në pikën 2, kreu IV i urdhrit nr.2152, datë 2.4.2002, ndryshon si më poshtë vijon:
“Lojërat elektronike: Fondi i ngurtësimit për lojërat elektronike të jetë në masën 50 mijë lekë për çdo makinë elektronike dhe jo më shumë se 5 milionë lekë.”

4. Shoqëritë e lojërave të fatit sportive të licencuara, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, detyrohen të rrisin fondin e garancisë për fituesit në masën 20 milionë lekë brenda një periudhe prej 6 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Ngarkohet Drejtoria e Lojërave të Fatit të kryejë çngurtësimet e fondit të garancisë për fituesit për shumat në masën mbi atë të përcaktuar në pikën 1 dhe 3 të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

VENDIM
Nr. 4, datë 10.2.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 3.11.2004 dhe 12.11.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26/6 Akti që i përket:

KËRKUES: COCA COLA BOTTLING SHPK, TIRANË, përfaqësuar nga avokate Alketa Uruçi, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: DEGA E TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit, Petrit Myftari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.368, datë 5.3.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe neni 328 i Kodit të Procedurës Civile.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të sipërm:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë gabimisht ka konsideruar datën 17.7.2001 si datë të paraqitjes së padisë, sepse nga aktet rezulton se ajo është paraqitur brenda afatit, më datë 13.7.2001;

- Referimi i gabuar për datën e paraqitjes së padisë e ka çuar Kolegjin Civil në dhënien e një vendimi antikushtetues duke i mohuar të drejtën e ankimit në gjykatë, gjë që e bën procesin të parregullt.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar pretendoi para Gjykatës Kushtetuese se kërkuesi ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit për të realizuar ankimin në rrugë administrative dhe në gjykatë. Ai parashtrroi gjithashtu se kërkuesi për një kohë të gjatë ka refuzuar pagimin e detyrimit, i cili do të përligjte ankimin, dhe pas ndërhyrjeve të shumta në datë 7.5.2001 ka bërë pagesën, çka përbën një ekzekutim vullnetar të detyrimit. Në këto kushte, kërkuesi nuk ka respektuar kërkesat e neni 328 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuessit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuessi Coca Cola Bottling sh.p.k., Tiranë, është shoqëri e regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar me vendimin nr.5298, datë 26.6.1993 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Drejtorja e Tatim Taksave Tiranë, me urdhërpagesën e datës 4.5.2001, ka kërkuar nga shoqëria derdhjen e shumës 957 112 lekë si interes për pagimin me vonesë të TVSH-së. Kërkuessi e ka paguar shumën e kërkuar në datën 7.5.2001 dhe me shkresën e datës 31.5.2001 ankohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Në përgjigje të ankimit, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.1744/1, datë 13.6.2001, njofton kërkuessin se e konsideron të drejtë vendimin e marrë nga Drejtorja e Tatim Taksave Tiranë dhe e lë atë në fuqi.

Në datë 13.7.2001, shoqëria Coca Cola Bottling sh.p.k., Tiranë ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesëpadinë ndaj degës së tatim taksave Tiranë (e zëvendësuar në gjykim nga dega e tatimpaguesve të mëdhenj) me objekt shfuqizimin e urdhërpaguesave të lëshuara në datë 4.5.2001.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1985, datë 13.5.2002, ka pranuar padinë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.1185, datë 8.11.2002. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.368, datë 5.3.2004 ka vendosur prishjen e vendimeve dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë arsyetohet se shoqëria Coca Cola ka marrë përgjigjen e ankimit nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve në datë 13.6.2001 dhe se padinë në gjykatë e ka paraqitur në datë 17.7.2001, pra tej afatit ligjor të parashikuar në nenin 328 të Kodit të Procedurës Civile e për rrjedhojë gjykatat nuk mund të investoheshin për shqyrtimin e çështjes në themel.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi i kërkuessit për shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është i drejtë.

E drejta e individëve për t'u ankuar në gjykatë kundër akteve e veprimeve administrative ka për qëllim kontrollin e këtyre të fundit për respektimin e parimeve kushtetuese e ligjore në funksion të realizimit të drejtësisë. Kjo është një garanci e domosdoshme në një shoqëri demokratike për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve dhe një ndër parimet më të rëndësishme kushtetuese që është e drejta e çdo individi për t'u dëgjuar çështja e tij para një gjykate, siç përcaktohet në nenin 42 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese në shqyrtimin e çështjeve të tilla u përmbahet kriterëve kushtetuese e ligjore, si dhe praktikës së saj që ankimi në gjykatë ndaj akteve e veprimeve administrative të kondicionohet edhe nga respektimi i kërkesave ligjore nga palët, siç janë pagimi i detyrimeve dhe respektimi i afateve. Në rastin konkret, kërkuessi i ka përmbushur detyrimet e tij ligjore si kushte paraprake për ushtrimin e ankimit në gjykatë dhe çështja e tij duhet të ishte shqyrtuar duke i garantuar një proces të rregullt gjyqësor.

Nga aktet që administrohen në dosje rezulton se data e paraqitjes së padisë nuk është 17.7.2001, siç ka pranuar padrejtësisht Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, por data 13.7.2001. Për rrjedhojë, padia është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 328 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo vërtetohet si me shënimin "U depozitua datë 13.7.2001", vendosur nga sekretaria e gjykatës në kopjen e kërkesëpadisë, ashtu edhe me vulën e vendosur mbi pullat e taksës që mban të njëjtën datë. Data 17.7.2001 nuk është data e depozitimit të padisë, por e caktimit të gjyqtarit të çështjes nga kryetari i gjykatës. Referimi i gabuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për datën e paraqitjes së padisë e ka çuar atë në dhënie e një vendimi antikushtetues, duke i mohuar kërkuessit një nga të drejtat themelore kushtetuese, atë të ankimit në gjykatë kundër një akti administrativ dhe për rrjedhojë, ka cenuar të drejtën për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Në rrethanat e paraqitura, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ishte i detyruar ta shqyrtonte çështjen dhe të shprehej në lidhje me pretendimet e parashtruara në recurs. Duke e konsideruar padrejtësisht paraqitjen e padisë jashtë afatit ligjor, ky kolegji ka zhvilluar një proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

Gjykata Kushtetuese thekson se në rastin konkret kemi të bëjmë me një qëndrim të gabuar e të padrejtë, si rezultat i të cilit mohohet ankimi në gjykatë ndaj një vendimi administrativ. Sigurisht që ankimi në gjykatë ndaj një akti administrativ nuk është i pakufizuar dhe një nga kushtet ligjore që duhet respektuar është edhe afati i paraqitjes së padisë. Në rast se ajo paraqitet jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, gjykatat nuk mund të investohen për shqyrtimin e çështjes. Në lidhje me llogaritjen e afateve gjykata është e detyruar të zbatojë kriteret ligjore dhe jo të caktojë kriteret e tjera duke shkelur të drejtat e palëve. Në shqyrtimin e kësaj çështjeje Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke injoruar faktet reale ka marrë një vendim të paligjshëm e arbitrar dhe ka shkelur një të drejtë kushtetuese të palës për akses në gjykatë. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesin në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.368, datë 5.3.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 3, datë 26.1.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR DHËNIEN E LICENCËS, PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 12 shkronja a dhe nenit 43 shkronja c të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 8 pika 1 të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për dhënie e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.71, datë 11.9.2002, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

“Në nenin 1, pikën 1.5 dhe pikën 1.6 vlefte prej 700 milionë lekësh të zëvendësohet me “1 miliardë lekë”.”

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Ardian Fullani**

VENDIM
Nr. 4, datë 1.2. 2005

PËR MOSPËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
SHOQËRISË KORSEL SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe vendimit nr.6, datë 23.5.2002 "Për miratimin e procedurave të vendosjes dhe rishikimit të çmimeve në kompanitë e licencuara", Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.2.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "KORSEL" sh.p.k. dhe relacionin e përgatitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve, konstaton, se në zbatim të procedurave të vendosjes dhe rishikimit të çmimeve në kompanitë e licencuara, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria "KORSEL" sh.p.k. ka këto mangësi:

- Në kërkesën e kompanisë nuk është përcaktuar periudha për të cilën kërkohet të miratohet çmimi.

- Nuk janë paraqitur dokumentet (aktrakordimet) me KESH sh.a., për sa i përket prodhimit të realizuar nga kjo kompani për periudhën që aplikohet.

- Mungojnë dokumentet nga dega e tatimeve dhe taksave ku ushtron veprimtarinë shoqëria, mbi numrin e punonjësve të siguruar nga kjo shoqëri dhe masën e kontributit të derdhur për çdo muaj.

Në bazë të konstatimeve të përmendura më sipër, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike

VENDOSI:

1. Të mospërcaktojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria "KORSEL" sh.p.k., deri në paraqitjen e plotë të dokumentacionit.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve të informojë shoqërinë "KORSEL" sh.p.k. mbi dokumentacionin e nevojshëm që një shoqëri duhet të dërgojë në ERE, kur aplikon për përcaktim çmimi të energjisë elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 5, datë 1.2.2005

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
SHOQËRISË MARJAKAJ SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.2.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "MARJAKAJ" sh.p.k. dhe relacionin e përgatitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria "MARJAKAJ" sh.p.k., për periudhën 1 tetor 2004–30 shtator 2005, të jetë 3.78 lekë.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 12, datë 28.1.2005

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR
TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT**

Në mbështetje të shkronjave “e” dhe “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 20.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve” dhe të neneve 71, 72, 73, 74, 75 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për sigurimin, risigurimin dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit” sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kjo rregullore t’u dërgohet të gjitha shoqërive të sigurimit për zbatim.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
Ky vendim hyn në fuqi më 28.1.2005

**KRYETARI I KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba**

RREGULLORE
Nr. 5, datë 28.1.2005

PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

- 1.1. Në këtë rregullore përcaktohen:
 - Kriteret dhe procedurat për shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar, që do të emërohen nga shoqëritë e sigurimit pas aprovimit nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve.
 - Përmbajtja e raporteve të kontrollit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 1.2. Baza ligjore e kësaj rregulloreje përbëhet nga: ligji nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, neni 71, ligji nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, kreu III dhe ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.
- 1.3. Subjekte të kësaj rregulloreje janë shoqëritë e sigurimit dhe degët e shoqërive të huaja, të licencuara ose që janë në proces licencimi nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve për të kryer veprimtari sigurimi në Republikën e Shqipërisë, që në vijim do të quhen “shoqëri sigurimi”.
- 1.4. Për efekt të kësaj rregulloreje “Kontrolli i ushtruar nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar” përfshin:
 - a) kontrollin e raporteve bazë financiare, që në vijim do të quhen “raporte financiare” që përgatiten nga shoqëria e sigurimit në përputhje me “Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar”, përveç kur është parashikuar ndryshe në ligjin “Për kontabilitetin” dhe ligjin nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë në sigurime, risigurime dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”;

b) vlerësimin e pasqyrave financiare me karakter specifik të përgatitura nga shoqëria e sigurimit, në përputhje me ligjin nr.9267, datë 29.7.2004 dhe aktet nënligjore të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve;

c) vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë së zbatimit të akteve nënligjore dhe të procedurave me të cilat operon shoqëria e sigurimit.

Neni 2

Kushtet dhe dokumentacioni i kërkuar

2.1. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për shoqërinë e ekspertëve kontabël të autorizuar të zgjedhur nga vetë ajo, jo më vonë se 30 qershori i çdo viti kalendarik.

2.2. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve miraton shoqërinë e ekspertëve kontabël të autorizuar, kur kandidati për ekspert kontabël i paraqitur për miratim është “ Shoqëri e ekspertëve kontabël të autorizuar”, e regjistruar në listën e IEKA-s.

2.3. Për të marrë miratimin e shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar të emëruar, shoqëria e sigurimit paraqet në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve, dokumentacionin si më poshtë:

- Vendimin e asamblesë së aksionarëve të shoqërisë së sigurimit, për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar;

- programin e kontrollit;

- letrën e angazhimit të paraqitur nga shoqëria e ekspertëve kontabël e emëruar;

- vërtetimin nga autoriteti licencues, që vërteton se shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë si shoqëri ekspertësh kontabël në sektorin financiar ose shoqëria ndërkombëtare e auditimit, me të cilën shoqëria e auditimit e krijuar në Shqipëri, e zotëruar (filiale) dhe e kontraktuar prej saj, ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë në fushën e ekspertizës kontabël në sektorin financiar;

- si dhe të dhëna të tjera specifike të kërkuara nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve.

2.4. Dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose fotokopje të noterizuar. Kur dokumentacioni është në gjuhë të huaj, origjinal ose fotokopje e noterizuar, do të jetë i shoqëruar nga përkthimi në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

2.5. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të marrë miratimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, për çdo ndryshim të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar.

Neni 3

Miratimi ose refuzimi i shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar

3.1. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve brenda një muaji nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë të kërkuar sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje miraton ose refuzon shoqërinë e ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë së sigurimit.

3.2. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve njofton shoqërinë e sigurimit brenda 10 ditëve. Mangësitë duhet të plotësohen nga shoqëria e sigurimit brenda 15 ditëve pune.

3.3. Miratimi i emërimit të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar bëhet nga Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

3.4. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve mund të refuzojë shoqërinë e ekspertëve kontabël të autorizuar kur gjykon se ky ekspert, në auditimin e mëparshëm, nuk ka vepruar në përputhje me ose nuk ka plotësuar në mënyrë të mjaftueshme kërkesat e nenit 4, të pikës 5.1 të nenit 5, të pikës 6.1, 6.4 të nenit 6 dhe të nenit 7 të kësaj rregulloreje ose të kërkesave të tjera për të cilat është rënë dakord me shkrim.

Neni 4

Kontrolli i raporteve financiare

4.1. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar e miratuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve kontrollon nëse raportet financiare të shoqërisë së sigurimit janë përgatitur në përputhje me “Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar”, përveç kur është parashikuar ndryshe në ligjin “Për kontabilitetin”, ligjin nr.9267, datë 29.7.2004 dhe aktet nënligjore të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

4.2. Kontrolli i raporteve financiare, sipas pikës 4.1 të këtij neni, kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

4.3. Mbi bazën e ekzaminimit të bërë, sipas pikës 4.1 dhe 4.2 të këtij neni, shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar jep një opinion, duke vënë në dukje nëse raportet financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të aktiveve, të detyrimeve, të kapitalit, të *cash-flow-t* etj. dhe nëse shoqëria e sigurimit përmbush kërkesat për aftësinë paguese apo kërkesa të tjera të autoritetit siç përcaktohen në ligjin nr.9267, datë 29.7.2004.

Neni 5

Opinionin i shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar

5.1. Në bazë të kontrollit që u ka bërë raporteve financiare për vitin ushtrimor, shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar përgatit raportin përkatës mbi këtë kontroll, të ushtruar në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe ua dorëzon këtë raport drejtuesve të shoqërisë së sigurimit.

5.2. Drejtuesit e shoqërisë së sigurimit ia paraqesin për miratim asamblesë së zakonshme të aksionarëve raportet financiare vjetore të audituara nga shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar së bashku me opinionin e tij.

5.3. Pas marrjes së vendimit përkatës nga asambleja e aksionarëve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 5.2 të këtij neni, shoqëria e sigurimit publikon në një nga botimet periodike financiare: paketën e plotë të pasqyrave financiare, së bashku me opinionin e shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar brenda 15 ditëve nga data e miratimit të raportit vjetor nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, por jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.

5.4. Një kopje e botimit të shoqërisë së sigurimit, publikuar sipas pikës 5.3 të këtij neni, dërgohet edhe në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve

Neni 6

Vlerësimi i pasqyrave financiare me karakter specifik

6.1. Në rastet kur shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar nuk mund të japë një vlerësim mbi bazën e rezultateve të arritura nga ekzaminimi i pasqyrave financiare, ai bën komente mbi çdo pasqyrë për të cilën nuk mund të jepet vlerësim pozitiv dhe paraqet parregullsitë e vëna re në pasqyrën në fjalë.

6.2. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar dorëzon vlerësimin me shkrim te drejtuesit e shoqërisë së sigurimit.

6.3. Pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me aktet nënligjore të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, së bashku me raportin/vlerësimin e shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar, paraqiten nga drejtuesit e shoqërisë së sigurimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve jo më vonë se 1 muaj pas përfundimit të periudhës raportuese.

6.4. Çdo pasqyrë financiare e shoqërisë së sigurimit do të jetë e nënshkruar paraprakisht nga drejtuesit e shoqërisë së sigurimit.

Neni 7

Procedura të tjera kontrolli

7.1. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar bën vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë së zbatimit të akteve nënligjore dhe të procedurave me të cilat operon shoqëria e sigurimit. Kjo përfshin vlerësimin nga ana e shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar:

a) për organizimin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit;

b) për cilësinë dhe zbatimin e rregulloreve të brendshme të shoqërisë së sigurimit për administrimin e aktiveve dhe pasiveve;

c) për organizimin e sistemit të teknologjisë dhe informacionit dhe koordinimin e tij me objektivat e biznesit dhe me ruajtjen e integritetit të të dhënave.

7.2. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar kërkon paraprakisht dhe vlerëson shqetësimet e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve për aspekte të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

7.3. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar përgatit një raport në të cilin shpreh opinionin dhe vlerësimin e saj mbi rezultatet e nxjerra për organizimin dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit; mbi cilësinë e rregulloreve të shoqërisë së sigurimit dhe zbatimin e tyre, të cilin e dorëzon te drejtuesit e shoqërisë së sigurimit.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

8.1. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar e shoqërisë së sigurimit, e miratuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, kryen kontrollin në të njëjtën shoqëri sigurimi për një periudhë jo më të gjatë se dy vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të saj, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

8.2. Sipas kërkesës së bërë nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, drejtuesit e shoqërisë së sigurimit paraqesin për dijeni në Autoritet “letrën për drejtimin” që shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar përgatit për drejtuesit e lartë të shoqërisë së sigurimit.

8.3. Një kopje e raporteve të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar, të përgatitura sipas kërkesave të neneve 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje apo çdo raporti tjetër të kërkuar i dërgohen Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve nga drejtuesit e shoqërisë së sigurimit, jo më vonë se afatet e përcaktuara në nenet 72 dhe 75 të ligjit nr.9267 datë 29.7.2004 apo afate të tjera të vendosura nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve.

8.4. Përfaqësues të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, të shoqërisë të ekspertëve kontabël të autorizuar dhe përfaqësues të shoqërisë së sigurimit zhvillojnë takime të rregullta periodike:

- para ose pas përfundimit të ekzaminimit të plotë të kryer në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve pranë shoqërisë së sigurimit;

- në rrethana kur merren vendime të rëndësishme për shoqërinë e sigurimit.

8.5. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë së sigurimit, çdo informacion mbi veprimtarinë e saj. Shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar është e çliruar nga sekreti profesional në dhënien e informacionit për Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve.

8.6. Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.12, datë 28.1.2005 të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba

UDHËZIM
Nr. 1, datë 10.2.2005

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRAVE RAJONALE ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe 17 të ligjit nr.9087, datë 19.6. 2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit të tij nr. 119, datë 29.10.2004 “Për miratimin në parim të projektit për krijimin e Zyrave Rajonale Zgjedhore të KQZ-së”,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

I. Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Zyrave Rajonale Zgjedhore, të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe caktimin e rregullave mbi marrëdhëniet me KQZ-në dhe me të tretët.

Neni 2
Parime të përgjithshme

I. Zyrat Rajonale Zgjedhore ngrihen për të vendosur një koordinim dhe komunikim më të mirë dhe më efikas midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, subjekteve zgjedhore dhe organeve të qeverisjes vendore, në funksion të miradministrimit të procesit zgjedhor, rritjes së transparencës në veprimtarinë e KQZ-së.

II. Në asnjë rast ZRZ-të nuk paraqiten si organe vendimmarrëse. Ato kanë një funksion tërësisht mbështetës në punën e administratës së KQZ-së.

Neni 3

I. Gjatë veprimtarisë së tyre ZRZ-të udhëhiqen nga parimet bazë të administrimit të një procesi zgjedhor, si:

- a) ligjshmëria;
- b) transparenca;
- c) paanshmëria;
- d) profesionalizmi.

PJESA II
VENDNDODHJA DHE PERSONELI I ZYRAVE RAJONALE ZGJEDHORE

Neni 4
Vendndodhja

I. Zyrat Rajonale Zgjedhore do të ngrihen në qendrat e 12 qarqeve të vendit: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

Neni 5
Përbërja e personelit

I. Secila zyrë do të ketë personelin e saj, i cili do të përbëhet nga një inspektor rajonal dhe asistent/ë.

Neni 6
Inspektori rajonal

I. Në rekrutimin e inspektorit rajonal mbahen parasysh, për aq sa është e mundur, rregullat e shërbimit civil. Krahas kërkesave të përgjithshme të nëpunësit të administratës publike, inspektori rajonal duhet të plotësojë edhe kërkesat e veçanta, të renditura si vijon:

- a) Të jetë me banim në qytetin qendër qarku;
- b) Të mos ketë qenë anëtar i ndonjë partie politike në tre vitet e fundit;
- c) Të mos ketë lidhje gjinie dhe/ose krushqie deri në shkallën e dytë me ndonjë prej kandidatëve për deputetë të zonave zgjedhore që përfshihen në qarkun përkatës.
- d) Të mos ketë qenë i zgjedhur apo kandidat në organet e qeverisjes vendore apo Kuvend në njësitë zgjedhore brenda qarkut në katër vitet e fundit;
- e) Të ketë arsimin e lartë, me përparësi atë juridik;
- f) Të ketë jo më pak se dy vjet eksperiencë pune në administratë dhe/ose në fushën e zgjedhjeve;
- g) Të njohë programet bazë të kompjuterit;
- h) Të mos ketë punuar në organet e Policisë së Shtetit, organe policie të tjera apo Shërbimin Informativ Shtetëror në katër vitet e fundit.

Neni 7
Asistenti

I. Asistenti duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi për inspektorin rajonal. Ai është ndihmësi i inspektorit në menaxhimin e problematikës së përditshme.

Neni 8
Dokumenti i identifikimit

I. Gjatë ushtrimit të detyrës, inspektori rajonal dhe asistenti janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit sipas modelit që përdoret nga administrata e KQZ-së.

PJESA III
EMËRIMI DHE SHKARKIMI I PERSONELIT TË ZYRËS RAJONALE ZGJEDHORE

Neni 9
Emërimi i personelit të Zyrës Rajonale Zgjedhore

I. Personeli i Zyrës Rajonale Zgjedhore emërohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me propozim të drejtorit të Komisioneve Zgjedhore, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 10
Shkarkimi i personelit të Zyrës Rajonale Zgjedhore

- I. Personeli i Zyrës Rajonale Zgjedhore shkarkohet nga detyra nga KQZ-ja,:
- a) kur nuk zbaton detyrat e ngarkuara;
 - b) kur shkel parimet e përcaktuara në nenin 3 të këtij udhëzimi;

- c) kur jep dorëheqjen;
- d) kur nuk plotëson kërkesat e nenit 6 të këtij udhëzimi.

PJESA IV
DETYRAT DHE TË DREJTAT E PERSONELIT TË ZYRËS RAJONALE ZGJEDHORE

Neni 11
Detyrat e personelit të Zyrës Rajonale Zgjedhore

I. Personeli i Zyrës Rajonale Zgjedhore ka për epror të drejtpërdrejtë drejtorin e Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore dhe kryen detyra të karakterit ekzekutiv dhe organizativ si më poshtë:

- a) Realizon përcjelljen në kohë të vendimeve dhe udhëzimeve të KQZ-së në KZZ, si dhe përcjelljen e vendimeve të KZZ-ve në KQZ;
- b) Jep ndihmesë në organizimin e trajnimeve të komisionerëve zgjedhorë, lidhur me sigurimin e bazës logjistike, lajmërimin e komisionerëve etj.;
- c) Mban kontakte të vazhdueshme me organet e qeverisjes vendore për probleme logjistike të shpërndarjes dhe grumbullimit të materialeve zgjedhore brenda afateve të përcaktuara në ligj;
- d) Mban kontakte me subjektet zgjedhore vendore;
- e) Informon KQZ-në në mënyrë të vazhdueshme mbi aktivitetin e komisioneve zgjedhore vendore;
- f) Kryen detyra të tjera sipas udhëzimeve të marra nga KQZ-ja.

Neni 12
Të drejtat e personelit të Zyrës Rajonale Zgjedhore

I. Personeli i ZRZ-së gëzon mbrojtjen e KQZ-së në kryerjen e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim. Atij i garantohen kushte të përshtatshme për zhvillimin normal të aktivitetit të tyre.

Neni 13
Komunikimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

I. Çdo lloj raporti apo informacioni i çdo natyre që të jetë i ZRZ-së, u shpërndahet menjëherë anëtarëve të KQZ-së nga Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore.

II. Këto Zyra kanë detyrimin t'u përgjigjen kërkesave për informacion të çdo anëtari të KQZ-së dhe të komunikojnë drejtpërdrejt me ta.

PJESA V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14
Periudha e funksionimit

I. Zyra Rajonale Zgjedhore funksionon për një periudhë pesëmuajore.

Neni 15
Koha e punës

I. Personeli i Zyrës Rajonale Zgjedhore e zhvillon aktivitetin e vet sipas orarit të punës, që aplikohet nga administrata e KQZ-së.

Neni 16

Paga

I. Personeli i Zyrës Rajonale Zgjedhore do të paguhet në bazë të kontratave individuale të punës, që do të lidhen ndërmjet tyre dhe Departamentit të Personelit të KQZ-së

Neni 17

Baza materiale dhe dokumentacioni

I. Baza materiale e marrë në dorëzim nga KQZ-ja (kompjuter, printer, aparat fotokopje, telefoni&faksi etj.) dhe dokumentacioni i përdorur nga Zyra Rajonale Zgjedhore, në përfundim të periudhës së funksionimit të saj dorëzohet në KQZ.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM

Nr. 305, datë 28.1.2005

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“TV BAJRAM CURRI”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.017/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulën në frekuencë, subjektin z. Ismail Buçpapa për “TV Bajram Curri”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Halil Lalaj

VENDIM

Nr.306, datë 28.1.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “RADIO 7”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.032/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulën në frekuencë, subjektin

“Media J-7” sh.p.k. për “Radio 7”.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi të mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 6.11.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr. 307, datë 28.1.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “EMANUEL”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.035/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin “Emanuel” sh.p.k. për “Radio Emanuel”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 15.1.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr. 308, datë 28.1.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIFONIK “RADIO E PARË”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.033/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin z.Genc Murati.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 15.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr. 309, datë 28.1.2005

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “KRUJA”

SUBJEKTIT:SHOQËRIA “JU-AL KABËLL KRUJA” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “JU-AL Kabëll Kruja” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Krujës, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me vendimin nr.638, datë 20.12.2004 vendosi të shpallë të zhdukur shtetasin Festim Bezat Beqiri, lindur në Pogradec, më 7 shtator 1975 dhe i zhdukur më datën 7 nëntor 1996.

KËRKESË

Shtetësja Neziha Kazani, lindur dhe banuese në Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Rexhep Ypi, i datëlindjes 4.9.1920 lindur në Starje të Kolonjës.

KËRKUESE
Nezihe Kazani

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 21.2.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë